



MISIONI NDËRKOMBËTAR I VËZHIMIT TË ZGJEDHJEVE Republika e Shqipërisë – Zgjedhjet Parlamentare, 25 prill 2021

DEKLARATË E GJETJEVE DHE PËRFUNDIMEVE PARAPRAKE

PËRFUNDIMET PARAPRAKE

Në zgjedhjet e 25 prillit, zgjedhësit patën mundësi të zgjidhnin mes kandidatëve, të cilët mundën të bënin fushatë në mënyrë të lirë dhe në kushtet e një kuadri ligjor që respekton liritë themelore. Pas një marrëveshjeje të re që i dha fund një ngërçi politik, aktorët kryesorë patën besim të mjaftueshëm për të marrë pjesë në zgjedhje. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), tashmë i reformuar, iu përkushtua mbikqyrjes së procesit zgjedhor në mënyrë të organizuar dhe transparente, pavarësisht detyrimeve të reja të konsiderueshme, duke përfshirë edhe zbatimin e teknologjive të reja. Partia qeverisëse mori avantazhe të konsiderueshme nga të qenit në pushtet, duke përfshirë përmes kontrollit të administratës lokale dhe nga shpërdorimi i burimeve të administratës publike. Kjo u amplifikua përmes mbulimit pozitiv të institucioneve shtetërore në media. Pretendimet për shitblerje votash qenë të vazhdueshme gjatë fushatës dhe nisi një numër i madh hetimesh. Në numrin e kufizuar të qendrave të votimit dhe të vendeve të numërimit që u vëzhguan, procesi qe kryesisht transparent dhe i qetë.

Zgjedhjet parlamentare u mbajtën pas një marrëveshjeje të re politike të arritur në qershor të vitit 2020, e cila u pasua nga reforma zgjedhore. Këto zgjedhje u zhvilluan në kuadrin e bisedimeve në proces e sipër për aderimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Kushtetuta garanton liri themelore dhe pavarësisht disa paqartësive dhe mungesës së konsistencës, Kodi Zgjedhor shërben si një bazë e përshtatshme për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Megjithëse ndryshimet e korrikut të vitit 2020 në Kodin Zgjedhor bazoheshin në një konsensus të gjerë politik dhe vinin pas një procesi gjithëpërfshirës konsultimi, ndryshimet e mëtejshme kushtetuese dhe zgjedhore të tetorit 2020 nuk u paraprinë nga konsultimet e duhura me aktorët. Edhe pse një sërë rekomandimesh të ODIHR-it dhe të Këshillit të Evropës u adresuan gjatë reformës zgjedhore, disa rekomandime mbeten ende të paadresuara.

Të 140 anëtarët e parlamentit zgjidhen për një mandat katër-vjeçar përmes një sistemi rajonal proporcional të modifikuar së fundmi, ku zgjedhësit kanë mundësi të votojnë në mënyrë preferenciale për kandidatë të caktuar në 1 nga 12 zonat zgjedhore përmes listave shumë-emërore. Ky sistem lejon edhe kandidimin e kandidatëve të pavarur. Numri i mandateve që i caktohet secilës zonë në përgjithësi garantoi barazinë e votës. Parlamenti i ri mblidhet jo më herët se shtatori i vitit 2021.

Zgjedhjet parlamentare u organizuan përgjithësisht mirë nga administrata zgjedhore. Komisioni i sapoformuar Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) u përball me detyrime të reja të zgjeruara pas ndryshimeve të fundit ligjore. Pavarësisht vonesave, duke përfshirë vonesat në miratimin e rregulloreve kyçe dhe në fillimin e fushatës për edukimin e zgjedhësve, si dhe në trajnimin e stafit të qendrave të votimit, KQZ-ja arriti t'i përmbushë si duhet pjesën më të madhe të detyrimeve të saj. Ajo operoi me transparencë dhe mbajti seanca të hapura për publikun, të transmetuara në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të hapura për pjesëmarrjen e aktorëve. Administrimi zgjedhor në të gjitha nivelet gëzoi përgjithësisht besimin e aktorëve.

Lëvizja drejt futjes së votimit elektronik ishte pjesë e marrëveshjes politike dhe e reformës zgjedhore të vitit 2020. Në përputhje me praktikën e mira zgjedhore, KQZ-ja pilotoi teknologji të reja votimi dhe numërimi në 32 qendra votimi në Tiranë nga 5,199 qendra votimi në të gjithë vendin. Afati

jashtëzakonisht i shkurtër për zbatimin e tyre nuk la mundësi për diskutime publike thelbësore dhe për mbikëqyrje të pavarur të teknologjive të reja.

Regjistrimi i zgjedhësve është pasiv, por në lidhje me saktësinë e listave të zgjedhësve nuk u ngrit asnjë shqetësim i konsiderueshëm nga bashkëbiseduesit e Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ). Sistemi i sapofutur në përdorim i identifikimit elektronik të zgjedhësve u vendos në të gjitha qendrat e votimit për ditën e zgjedhjeve. Shumica e bashkëbiseduesve të MNVZ-së shprehën vlerësim për këtë sistem të ri dhe u shprehën se e perceptonin si një masë për zbutjen e rrezikut të votimit të dyfishtë, votimit familjar dhe të falsifikimit të identitetit të zgjedhësve. Koha e shkurtër e prokurimit dhe e instalimit nuk krijoi mundësi për diskutime publike thelbësore, një komponent i rëndësishëm për garantimin e besimit të publikut. Numri total i zgjedhësve të regjistruar ishte rreth 3.5 milion, duke përfshirë edhe ata që jetojnë jashtë vendit.

Në një proces gjithëpërfshirës dhe konsistent, KQZ-ja regjistroi 10 parti politike dhe 2 koalicione për të garuar në të gjithë vendin, si dhe 5 kandidatë të pavarur për të garuar në 5 zona. Në total, u regjistruan 1,871 kandidatë, ku përfshiheshin 732 gra (40 për qind). Ligji u lejon vetëm kryetarëve të partive, por asnjë kandidat tjetër, që të kandidojnë deri në katër zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta.

U respektua liria themelore e organizimit dhe subjektet zgjedhore patën mundësi të bënin fushatë lirisht, pavarësisht kufizimeve të vendosura për shkak të pandemisë së COVID-19 dhe zbatimit në mënyrë jokonsistente të gjobave për shkelje të rregullave. Fushatës i mungoi dinamika, duke qenë se mesazhet u fokusuan te drejtuesit kryesorë të partive dhe jo te diskutimet rreth çështjeve reale. Praktikrat gjerësisht të përhapura të shitblerjes së votave vazhduan të përbënin problem. Rrjedhja e të dhënave personale sensitive, duke përfshirë edhe preferencat politike të zgjedhësve përbën shqetësim serioz dhe i bën zgjedhësit vulnerabël.

Partitë kryesore tentuan që të gjitha ta rrisnin rolin dhe vizibilitetin e grave si kandidate në fushatë dhe kuotat e detyrueshme në listat e zgjedhësve u respektuan e, në shumicën e rasteve, u tejkaluan. Përpjekje u bënë edhe për t'i nxitur gratë të votonin. Gratë janë të nënperfaqësuar në të gjithë administratën zgjedhore. Kandidatet gra dhe aktorë të tjerë morën 39 për qind të mbulimit mediatik në lajmet e monitoruara dhe programet e aktualitetit.

Pavarësisht një kuadri ligjor solid që ndalon shpërdorimin e burimeve administrative dhe minimizon avantazhin e partisë në pushtet, ministrat vazhduan të bënin fushatë gjatë angazhimeve zyrtare. Publiciteti që erdhi si rrjedhojë e kësaj i dha partisë qeverisëse një avantazh të konsiderueshëm. Ofrimi i stimujve dhe presioni i pretenduar ndaj nëpunësve civilë përbënë shqetësim. Në kapacitetin e tij zyrtar, Presidenti bëri fushatë kundër partisë qeverisëse.

Partitë politike që kishin marrë të paktën 1 për qind të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare morën fonde publike për fushatën. Subjektet garuese mund edhe ta financonin fushatën e tyre me fondet e veta, me donacione nga qytetarë shqiptarë, nga subjekte juridike dhe me kredi bankare. Mbikëqyrja e financimit të fushatës është kompetencë e KQZ-së. Subjekteve u kërkohet të paraqesin raporte financiare vetëm pas zgjedhjeve, duke e kufizuar në këtë mënyrë transparencën dhe mundësinë e zgjedhësve për të bërë një zgjedhje të informuar dhe të bazuar tek informimi mbi burimet e fondeve të fushatave.

Mjedisi mediatik është i ngarkuar. Pavarësia editoriale ndikohet negativisht nga interesat e pronarëve, gjë që nxit autocensurën. Gazetarët vazhdojnë të mbeten vulnerabël ndaj presionit dhe korrupsionit. Rregulloret që rregullojnë mbulimin mediatik të fushatës e ngushtojnë aksesin në media të partive më të vogla dhe të kandidatëve të pavarur. Transmetuesit u frenuan nga bërja e një mbulimi të thelluar dhe

analitik të të gjitha subjekteve zgjedhore. Kjo, e kombinuar edhe me përmbajtjen e prodhuar nga vetë partitë në programet informative, e kufizoi mundësinë e zgjedhësve për të bërë zgjedhje të informuara. Fatkeqësisht, nuk u organizua asnjë debat televiziv mes drejtuesve politikë.

Kodi Zgjedhor parashikon një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Para ditës së zgjedhjeve, Komisioni i Ankesave i KQZ-së trajtoi 23 ankesa, të cilat lidheshin ndër të tjera me regjistrimin e kandidatëve dhe me shpërdorimin e burimeve të administratës publike. Kolegji Zgjedhor shqyrtoi edhe shtatë apelime kundër vendimeve të KQZ-së. Gjykimi i apelimeve si në KQZ, ashtu edhe në Kolegjin Zgjedhor, u bë në mënyrë të hapur dhe me pjesëmarrje, duke respektuar të drejtat procedurale të palëve. Ndërkohë janë nën hetim 30 raste që lidhen me shitblerje votash.

Ligji parashikon vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhguesit e partive, vëzhguesit vendas dhe ata ndërkombëtarë. Ndryshe nga vëzhguesit e partive, ai ende nuk i lejon vëzhguesit vendas që të marrin protokollin e rezultateve të numërimit dhe të nxjerrjes së rezultateve. KQZ-ja regjistroi 17 grupe vëzhguesish vendorë me rreth 2,000 vëzhgues.

MNVZ-ja nuk ndërmori një vëzhgim sistematik apo gjithëpërfshirës të procedurave në ditën e zgjedhjeve. Në atë numër të kufizuar qendrash votimi që misioni vizitoi, procesi ishte i qetë dhe fshehtësia e votës në pjesën më të madhe u respektua. MNVZ-ja qe dëshmitare e një rasti të shpërndarjes së parave zgjedhësve jashtë një qendre votimi. Në atë numër të vogël të vendeve të numërimit që misioni vëzhgoi, procesi qe kryesisht transparent dhe i qetë. KQZ-ja i nxori rezultatet e hollësishme paraprake në faqen e saj zyrtare afër mesnatës, duke garantuar në këtë mënyrë transparencë. Pjesëmarrja u raportua të ishte rreth 48 për qind. Në tërësi, masat parandaluese të COVID-19 nuk u zbatuan mirë dhe distancimi social nuk u respektua gjithmonë.

GJETJET PARAPRAKE

Konteksti

Më 6 shtator 2020, Presidenti Ilir Meta shpalli mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare më 25 prill 2021.

Partia Socialiste (PS) fitoi zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2017 me 74 nga 140 mandate.¹ Pjesa më e madhe e deputetëve të partive opozitare hoqën dorë nga mandatet në shenjë proteste në shkurt të 2019-ës.² Si rrjedhojë, Partia Demokratike (PD) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) vazhduan të vepronin si forca politike ekstra-parlamentare. Më pas, zgjedhjet vendore të 2019-ës u mbajtën pa pjesëmarrjen e partive opozitare që kishin bojkotuar, gjë që çoi në marrjen e të gjitha posteve të krerëve të bashkive nga koalicioni i drejtuar nga PS-ja, *Shqipëria Evropiane*.³ Efektivisht, PS-ja mori kontrollin absolut të qeverisë qendrore dhe asaj vendore.

Në mars të vitit 2020, Këshilli i Bashkimit Evropian hapi negociatat për aderimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Këshilli vendosi kushte të tjera, duke përfshirë këtu kushtin për reforma të tjera institucionale, si dhe zbatimin e rekomandimeve të ODIHR-it në lidhje me zgjedhjet, para se Shqipërisë

¹ Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017: Partia Socialiste (PS) - 74; Partia Demokratike (PD) - 43; Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) - 19; Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) - 3; Partia Social Demokratike (PSD) - 1.

² Pesëdhjetë e gjashtë deputetë të opozitës hoqën dorë nga mandatet.

³ Nga të 61 garat për bashkitë, koalicioni i drejtuar nga PS-ja fitoi 60 bashki, kurse partia e Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen fitoi 1 bashki. Sa u përket këshillave bashkiakë, koalicioni fitues mori më shumë se 96 për qind të mandateve.

t'i kushtohet Konferenca e parë ndër-qeveritare.⁴ Zhvillimi i këtyre zgjedhjeve shihet gjerësisht si një provë për progresin demokratik të Shqipërisë në bisedimet për aderimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Në qershor të vitit 2020, partia qeverisëse, partitë e opozitës parlamentare dhe asaj ekstra-parlamentare arritën një marrëveshje për t'i dhënë fund ngërçit politik, duke u fokusuar te reforma zgjedhore. Kjo i ktheu partitë opozitare sërish në procesin politik.

Peizazhi politik vazhdoi të dominohet nga dy parti të mëdha, PS-ja dhe PD-ja. Presidenti Meta, ish-kryetar i LSI-së, në ushtrimin e një roli jopolitik nga ana kushtetuese, ka një marrëdhënie publike të tensionuar me Kryeministrin Edi Rama dhe mori shpesh iniciativa ose e kritikoi publikisht qeverinë me termat më të fortë, duke ndikuar drejtpërdrejt zgjedhjet.⁵

Në legjislaturën e fundit të parlamentit, gratë mbetën të papërfaqësuar sa duhet, me 26 për qind të mandateve (36 deputete); megjithatë, në qeveri, ato mbajtën më shumë se gjysmën e posteve ministore.

Zgjedhjet parlamentare u zhvilluan në hijen e pandemisë globale të COVID-19 dhe ishin zgjedhjet e para që u mbajtën në Shqipëri që prej tërmetit të nëntorit 2019, i cili rezultoi në fatalitete dhe në dëme të mëdha, sidomos në qarkun e Durrësit.

Kuadri ligjor dhe sistemi zgjedhor

Kuadri ligjor përbëhet nga Kushtetuta e 1998-ës, Kodi Zgjedhor i 2008-ës, që të dy të ndryshuar për herë të fundit në vitin 2020, si dhe nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore në këtë fushë.⁶ Shqipëria është palë në disa instrumente të rëndësishme ndërkombëtare ligjore për zgjedhjet.⁷

Kushtetuta garanton liri themelore dhe Kodi Zgjedhor shërben si bazë e përshtatshme për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Megjithatë, disa paqartësi dhe mungesa e konsistencës në ligj, duke përfshirë edhe ato që u shkaktuan nga ndryshimet e fundit, e cenojnë sigurinë juridike dhe administrimin eficient të zgjedhjeve.⁸ Përveç kësaj, Misioni i Kufizuar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MKVZ) i ODIHR-it vuri re disa raste interpretimesh tejet të zgjeruara të legjislacionit, duke përfshirë edhe nga KQZ-ja në

⁴ [Këshilli i Bashkimit Evropian përcaktoi](#) se “[...] Shqipëria duhet ta miratojë reformën zgjedhore plotësisht në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, duke garantuar financimin transparent të partive politike dhe të fushatave zgjedhore [...]”.

⁵ Presidenti i emëruar në prill të vitit 2017 nga parlamenti i dalë nga zgjedhjet parlamentare të 2013-ës. Më 25 mars 2021, Presidenti Meta ndërmori iniciativën e tij të quajtur [Denonco Krimin Zgjedhor](#), përmes së cilës ai i inkurajoi qytetarët që të raportojnë çdo shkelje dhe premtoi “të ndërmerre të gjitha veprimet e nevojshme për adresimin e çdo denoncimi dhe për të bërë publike faktet që lidhen me ndërhyrjet e paligjshme në procesin zgjedhor.”

⁶ Duke përfshirë edhe Ligjin e vitit 2000 për Partitë politike, Ligjin e vitit 2001 për Demonstrimet, Ligjin e vitit 2013 për Mediat Audio-Vizive, Ligjin e vitit 2015 për Garantimin e Integritetit të Personave të Zgjedhur, të Emëruar ose që Ushtrjnë Funksione Publike (i ashtuquajtur Ligji i Dekriminalizimit), si dhe Ligjin e vitit 2008 për Barazinë Gjinore. KQZ-ja miraton akte nënligjore në zbatim të ligjeve.

⁷ Këtu hyn Konventa Ndërkombëtare e vitit 1966 për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), Konventa Ndërkombëtare e vitit 1965 për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial, Konventa e OKB-së e vitit 1979 për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventa e OKB-së e vitit 2003 kundër Korrupsionit, Konventa e vitit 2006 për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, si dhe Konventa Evropiane e vitit 1950 për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Shqipëria është anëtare e Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës dhe Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

⁸ Për shembull, neni 145 (2) i Kodit Zgjedhor i referohet një versioni të vjetër të nenit 24, i cili është hequr me ndryshimet e korrikut të 2020-ës; kufizimi i të drejtës së votës personave me aftësi të kufizuar intelektuale ose psikosociale u hoq nga neni 44 i Kodit Zgjedhor, por mbetet në Kushtetutë (neni 45) dhe në nenin 53 të Kodit Zgjedhor.

miratimin e akteve nënligjore, duke çuar shpesh në rregullime më strikte.⁹ Disa bashkëbisedues të MKVZ-së së ODIHR-it, duke përfshirë edhe në KQZ, u shprehën se ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor krijuan një sërë paqartësish dhe ngritën shqetësime rreth kapacitetit teknik për zbatimin e tyre, sidomos në kohën e shkurtër mes ndryshimeve dhe zgjedhjeve.

Pas një procesi të hapur, gjithëpërfshirës dhe të mirëplanifikuar, parlamenti, me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar, miratoi një sërë ndryshimesh në Kodin Zgjedhor më 23 korrik 2020. Këto ndryshime parashikuan të tjera garanci rregullatore kundër shpërdorimit të burimeve publike dhe forcuan garancitë për ekuilibrin gjinor në listat e kandidatëve, duke adresuar rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it. Këto ndryshime çuan edhe në ndryshime në strukturën e KQZ-së dhe në lidhje me procedurën e verifikimit të nominimit të kandidatëve, financimin publik dhe privat të fushatës, mbikqyrjen e mbulimit të fushatës në media, si dhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Reforma parashikoi gjithashtu edhe identifikimin elektronik të zgjedhësve në ditën e votimit, mundësinë e futjes së votimit nga jashtë vendit, si dhe të pilotimit të teknologjive të reja të votimit dhe të numërimit.

Më 30 korrik, me ndryshimet që u bënë në kushtetutë, u fut në përdorim votimi preferencial.¹⁰ Më pas, me ndryshimet e bëra në Kodin Zgjedhor më 5 tetor – zëvendësimi i pragut rajonal që u duhej kandidatëve të kalonin për t'u kualifikuar për marrjen e një mandati me një prag kombëtar prej 1 për qind – u parashikua një numër minimal kandidatësh në listat e partive dhe drejtuesit e partive politike dhe koalicioneve u lejuan që të kandidojnë deri në katër zona zgjedhore.¹¹ Në Opinionin e tyre të Përbashkët, Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës dhe ODIHR-i shprehën keqardhje që procedurat e miratimit të ndryshimeve në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor kishin qenë jashtëzakonisht të nxituara dhe që nuk ishin paraprirë nga një proces i duhur konsultimi. Ata vunë gjithashtu në dukje se ndryshimet në lidhje me numrin minimal të kandidatëve përbëjnë disavantazh për partitë më të vogla dhe se mundësia që u jepet drejtuesve të partive që të kandidojnë në disa zona zgjedhore njëherësh përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta.¹²

Pavarësisht reformave kushtetuese dhe zgjedhore të vitit 2020, disa rekomandime të mëparshme të ODIHR-it mbeten të paadresuara, duke përfshirë edhe ato që lidhen me të drejtën e votës së personave më aftësi të kufizuara intelektuale ose psiko-sociale, me përgjegjësinë penale për shpifjen, me përdorimin e materialeve e gatshme të fushatave të partive në edicionet e lajmeve, si dhe me të drejtat e barabarta të vëzhguesve të partive dhe të vëzhguesve vendas.

Parlamenti prej 140 anëtarësh zgjidhet për një mandat katër-vjeçar përmes një sistemi proporcional rajonal. Kandidatët zgjidhen nga 12 zona zgjedhore që përkrijnë me qarqet administrative, përmes listave shumë-emërore të kandidatëve. Numri i mandateve që i takon secilit qark varet nga numri i shtetasve të regjistruar në të dhe garantoj në përgjithësi barazinë e votës.¹³ Votimi preferencial brenda

⁹ Vendimi Nr. 9 i Rregullatorit përcakton aktivitetet e ndaluara të institucioneve publike, si aktivitete që, *inter alia*, bëjnë publicitetin e shpenzimeve të fondeve shtetërore ose të buxheteve vendore për të cilat janë caktuar ose që janë miratuar në periudhën 4-mujore para zgjedhjeve, kurse Kodi Zgjedhor i referohet “të gjitha aktiviteteve me natyrë publike” pa iu referuar aspak fondeve të sipërpërmendura. Neni 10 i Vendimit Nr. 11 të Rregullatorit, në lidhje me formimin e KQV-ve parashikon që anëtarët e KQV-ve të mund të zëvendësohen me kërkesë të subjektit zgjedhor që i ka propozuar, ndërkohë që Kodi Zgjedhor nuk e parashikon këtë.

¹⁰ Disa parti e informuan MKVZ-në e ODIHR-it se nuk kishin qenë pro futjes së votimit preferencial.

¹¹ Edhe ndryshimet e tetorit 2020 në Kodin Zgjedhor parashikonin që njëra parti politike në koalicion duhet të marrë rolin drejtues dhe saktësonin disa procedura zgjedhore. Në nëntor 2020, u miratuan disa ndryshime në Ligjin për Partitë Politike për ta harmonizuar atë me Kodin Zgjedhor.

¹² Shih [Opinionin e Përbashkët të vitit 2020 të Komisionit të Venecias dhe ODIHR-it](#).

¹³ Në dhjetor të vitit 2020, Rregullatori vendosi për ndarjen e mandateve sipas qarqeve. Për shkak të demografisë, Tirana mori edhe dy mandate, kurse Dibra dhe Gjirokastra humbën që të dyja nga një mandat, krahasuar me zgjedhjet parlamentare të 2017-ës. Dy nga 12 qarqe e tejkalojnë shmangien prej 10 për qind nga numri mesatar i qytetarëve për mandat, ku qarku i Gjirokastrës dhe ai i Kukësit kanë përkatësisht një shmangie prej 13.7 dhe 13.0 për qind qytetarë më shumë për mandat. Kjo është në përputhje me praktikën e mirë zgjedhore.

listave të partive, i futur me ndryshimet e fundit, i jep mundësi zgjedhësit që të ndikojë në renditjen e kandidatëve në listë.

Për t'u kualifikuar për marrjen e një mandati në parlament, subjektet zgjedhore, duke përfshirë edhe kandidatët e pavarur, duhet të kalojnë pragun prej një përqind në shkallë vendi. Zbatimi i këtij pragu për kandidatët e pavarur mund të bëjë që atyre t'u duhet të marrin një numër votash ndjeshëm më të lartë sesa kandidatëve të partive në zonat elektorale përkatëse për të hyrë në parlament. Kështu, aplikimi i një pragu kombëtar prej 1 për qind për kandidatët e pavarur mund të sfidojë parimin e kandidimit në kushte të barabarta.

Administrata zgjedhore

Administrata zgjedhore përbëhet nga KQZ-ja, 92 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), dhe 5,199 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Numërimi bëhet nga Grupet e Numërimit (GN) në 92 Vende të Numërimit të Votave (VNV), një për secilën Zonë të Administrimit të Zgjedhjeve (ZAZ).

Ndryshimet ligjore të vitit 2020 i ndryshuan rregullat e formimit të KQZ-së dhe futën tre degë të dallueshme në strukturën e saj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri), Komisioni Rregullator (Rregullatori) dhe Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS)¹⁴. Rregullatori dhe KAS-i kanë secili nga pesë anëtarë. Të gjithë anëtarët e KQZ-së zgjidhen nga parlamenti me jo më pak se tre të pestat e votave. KZAZ-të dhe KQV-të kanë secila nga shtatë anëtarë të propozuar nga shumica parlamentare dhe nga opozita.¹⁵ Gratë janë më pak të përfaqësuar në të gjithë administratën zgjedhore; kuota prej 30 për qind parashikohet me ligj vetëm për përbërjen e KZAZ-ve.¹⁶ Administrata zgjedhore punoi përgjithësisht në mënyrë transparente dhe KQZ-ja gëzoi besimin e aktorëve.¹⁷

Ndryshimet në kuadrin ligjor sollën detyrime të reja për KQZ-në. Pavarësisht angazhimit të administratës zgjedhore, nuk pati kohë dhe burime të mjaftueshme për zbatimin e tyre në mënyrë efektive. Në tërësi, KQZ-ja u përball me një rritje progresive të ngarkesës për shkak të futjes së vonuar në përdorim të identifikimit elektronik të zgjedhësve dhe të një projekti pilot për votimin dhe numërimin elektronik.¹⁸ Ajo zhvilloi seanca të hapura për publikun, duke i transmetuar drejtpërdrejt edhe për median, për vëzhguesit dhe për përfaqësuesit e partive. Transparenca u rrit edhe më shumë përmes diskutimeve periodike online në lidhje me çështjet zgjedhore me shoqërinë civile, si dhe përmes publikimit të versioneve paraprake të vendimeve në faqen zyrtare të KQZ-së para se ato të miratoheshin.

Komisionet e niveleve më të ulëta zgjedhore u emëruan brenda afatit ligjor. Partitë politike mundet që ende t'i tërheqin komisionerët e emëruar prej tyre nga KZAZ-të sipas gjykimit të tyre, pavarësisht rekomandimeve të bëra më parë nga ODIHR-i.¹⁹ Që prej 23 prillit, KQZ-ja ka zëvendësuar 128 nga 736 (17 për qind) anëtarë të KZAZ-ve dhe i është dashur të garantojë trajnimin e të gjithë anëtarëve të rinj.

¹⁴ Sipas Kodit Zgjedhor, Rregullatori është organi kompetent për miratimin e akteve me natyrë normative.

¹⁵ Shumica më e madhe parlamentare dhe partia më e madhe e opozitës propozojnë nga dy anëtarë të KZAZ-ve secila. Përveç kësaj, shumica e dytë parlamentare dhe partia e dytë opozitare propozojnë nga një anëtar secila. Tre anëtarë të KZAZ-ve ishin emëruar nga PS-ja dhe nga PSD-ja, kurse tre nga PD-ja dhe nga LSI-ja. Për këto zgjedhje, edhe PD-ja dhe PS-ja emëruan anëtarin e shtatë në 46 KZAZ secila.

¹⁶ Tre nga dymbëdhjetë anëtarë të KQZ-së janë gra. Afërsisht një e treta (31.4 për qind) nga 736 anëtarë të emëruar fillimisht të KZAZ-ve ishin gra, por vetëm 15 për qind mbajtën pozicionin e kryetares.

¹⁷ Rezerva janë shprehur nga bashkëbisedues të MKVZ-së së ODIHR-it në lidhje me shqyrtimin e ankesave sidomos nga KAS-i për këto çështje: konfigurimi i fletës së votimit; dy çështje të ndara të shpërdorimit të burimeve publike të ngritura kundër Drejtorit të Kadastrës në Lushnje dhe kundër Kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

¹⁸ Komisioneri miratoi rreth 300 vendime, kurse Rregullatori më shumë se 30 akte rregullatore.

¹⁹ Kjo bie ndesh me Seksionin II.3.1.f të Kodit të Praktikave të Mira të Komisionit të Venecias për Çështjet Zgjedhore të vitit 2002, në të cilin thuhet se "organet që emërojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore nuk duhet të jenë të lirë t'i heqin ata sipas dëshirës".

Këto ndryshime nuk kanë pasur ndonjë ndikim të ndjeshëm në performancën e KZAZ-ve, aktivitetet e të cilave janë zhvilluar në përgjithësi në mënyrë profesionale.

KQZ-ja kishte përgjegjësinë e edukimit të zgjedhësve, duke përfshirë edhe votuesit që votojnë për herë të parë dhe grupet e cënueshme. Temat e trajtuara përfshinin konceptin e ri të identifikimit elektronik të zgjedhësve, konfigurimin e ri të fletës së votimit, procedurat e votimit dhe shitblerjen e votave. Përveç posterave dhe billboardëve, u transmetuan edhe spote në televizion dhe në mediat sociale. Megjithatë, shumë bashkëbisedues të MNVZ-së pretenduan se fushata e informimit të zgjedhësve ishte e pamjaftueshme dhe se kishte filluar me vonesë, sidomos sa i përket identifikimit të zgjedhësve dhe konfigurimit të ri të fletës së votimit. Kjo kontribuoi në krijimin e një konfuzioni në ditën e zgjedhjeve.

U pilotua votimi dhe numërimi elektronik i votave në një prej ZAZ-ve të qytetit të Tiranës, që përfshinte 32 qendra votimi (QV) me 23,597 votues të regjistruar.²⁰ Në këto QV, procesi i identifikimit të zgjedhësve u nda teknologjikisht nga procesi i votimit për të garantuar fshehtësinë e votës. KQZ-ja organizoi një demonstrim për nëntë ditë të pajisjes me akses për të gjitha palët e interesuara dhe zhvilloi një test për funksionimin e teknologjisë tre ditë para ditës së zgjedhjeve.²¹ Megjithatë, nuk u zhvillua asnjë auditim apo certifikim i pavarur, pasi kjo nuk parashikohet me ligj.²² Procesi i prokurimit të pajisjeve të votimit u mbyll një muaj para ditës së zgjedhjeve, kurse konfigurimi i programit kompjuterik (software) një javë para ditës së zgjedhjeve. Pavarësisht objektit të kufizuar të pilotimit, koha jashtëzakonisht e shkurtër nuk lejoi mundësi për diskutime publike thelbësore apo për një mbikqyrje të pavarur, duke përfshirë edhe nga shoqëria civile, të cilat janë që të dyja komponentë të rëndësishëm për garantimin e besimit në një teknologji të re votimi.²³

Regjistrimi i zgjedhësve

Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën e votës. Shtetasit që janë shpallur të pazotë me vendim gjykatë nuk mund të votojnë, gjë që është në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare, të cilat e ndalojnë diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar.²⁴ Shtetasit që janë duke kryer një dënim me burg për kryerjen e veprave të caktuara penale nuk mund të votojnë.²⁵

Megjithëse në Kodin Zgjedhor parashikohet si mundësi, qytetarëve nuk iu ofrua mundësia për të votuar jashtë vendit. Megjithatë, votuesit që jetojnë jashtë mund të kthehen dhe të votojnë në qendrat përkatëse të votimit, megjithëse në praktikë, kjo mund të jetë penguar nga masat e marra për shkak të COVID-19.

²⁰ Votimi u zhvillua me pajisje lokale të palidhura me internetin. Pajisjet e votimit konsistonin në një modul me ekran me prekje dhe në një printer të lidhur me gjurmët e kontrollit të letrës. Çdo QV kishte dy palë pajisje votimi.

²¹ Nga 3 deri më 11 prill, në demonstrimet publike morën pjesë 547 zgjedhës. Megjithatë, konfigurimi i fletës elektronike të votimit që u përdor në ditën e zgjedhjeve nuk ishte i njëjtë me atë që u demonstrua publikisht.

²² Në [Udhëzuesin e ODIHR-it për Vëzhgimin e Teknologjive të reja të Votimit](#) theksohet se “Në mënyrë që certifikimi të jetë i qenësishëm, organi i certifikimit duhet të jetë kompetent dhe i pavarur nga ofruesit/shitësit, furnitorët dhe administruesit e zgjedhjeve.”

²³ Sipas [Rekomandimit CM/Rec\(2017\)/5 të Këshillit të Evropës për standardet për votimin elektronik](#) “[...] vetëm sistemet e votimit elektronik që janë të sigurtë, të besueshëm, eficientë, teknikisht solid dhe të hapur ndaj verifikimit të pavarur dhe të aksesueshëm lehtësisht për zgjedhësit krijojnë besim te publiku, gjë që përbën një parakusht për mbajtjen e zgjedhjeve elektronike”.

²⁴ Ndonëse kufizimi i të drejtës së votës së këtyre personave është hequr nga një nen i Kodit Zgjedhor në korrik 2020, ky kufizim vazhdon të mbetet në Kushtetutë dhe në nene të tjera të Kodit Zgjedhor. Shih nenin 29 të [Konventës së vitit 2006 për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara](#), e cila i detyron shtetet që t’u “garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejta politike dhe mundësi për t’i gëzuar ato në mënyrë të barabartë me të tjerët”. Paragrafi 7.3 i [Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 të OSBE-së](#) parashikon që Shtetet pjesëmarrëse të “garantojnë të drejtën universale dhe të barabartë të votës për qytetarët që kanë arritur moshën për të votuar”.

²⁵ Ligji i Dekriminalizimit u pezullon të drejtën e votimit shtetasve që po kryejnë një dënim me burg për kryerjen e veprave penale të renditura në me shumë se 80 nene të Kodit Penal (duke variuar nga shkeljet zgjedhore e deri tek krimet e rënda). Sipas Ministrisë së Drejtësisë, këta qytetarë përbëjnë pothuajse gjysmën e të gjithë të burgosurve.

Sistemi i regjistrimit të zgjedhësve është pasiv. Ndryshe nga sa parashikohet në angazhimet ndërkombëtare, zgjedhësit me moshën mbi 100 vjeç ishin hequr automatikisht nga listat e zgjedhësve dhe u duhej të konfirmonin të dhënat për t'u futur sërish në lista.²⁶ Listat e zgjedhësve bazoheshin tek baza elektronike e të dhënave e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC), i cili mbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGjC)²⁷ nën Ministrinë e Brendshme. Korrigjime në listat e zgjedhësve mund të bëheshin deri në 40 ditë para zgjedhjeve, datë pas së cilës, zgjedhësit mund të korrigojnë të dhënat e tyre përmes gjykatave lokale. Pas afishimit përfundimtar të listave të zgjedhësve, zgjedhësit mund t'i kontrollojnë listat e printuara të zgjedhësve dhe qendrat e votimit në Zyrat lokale të Gjendjes Civile ose online. Që prej 15 marsit, numri total i zgjedhësve të regjistruar ishte 3,588,869, duke përfshirë edhe ata që jetojnë jashtë vendit.²⁸

KQZ-ja mbikqyri procesin e përpilimit të listës së zgjedhësve. Dy auditues të emëruar nga KQZ-ja në tetor 2020, vlerësuan saktësinë e listave të zgjedhësve dhe vunë re disa probleme, si ndryshime të të dhënave të adresave të zgjedhësve, pa informuar zgjedhësit dhe vonesa në dorëzimin e njoftimeve të zgjedhësve në disa bashki.²⁹ Shumica e bashkëbiseduesve të MKVZ-së së ODIHR-it shprehën besim tek procesi në tërësi i përpilimit të listave të zgjedhësve.

Zgjedhësit regjistrohen në listën e qendrës së votimit që mbulon vendbanimin e tyre. Sipas Kodit Zgjedhor, zgjedhësit mund të votojnë vetëm duke u paraqitur fizikisht në qendrën e votimit, kurse votimi me postë apo përmes kutive të lëvizshme të votimit nuk parashikohet. Sipas ligjit, mund të organizohen qendra të posaçme votimi në burgje, në qendrat e paraburgimit dhe në spitale.³⁰ Zgjedhësit që ishin infektuar me COVID-19 dhe që ndodheshin në karantinë, qenë të detyruar të respektonin rregullat e izolimit, duke çuar *de facto* në mohimin e së drejtës së tyre për të votuar.³¹

Për herë të parë, në të gjitha qendrat e votimit, në ditën e zgjedhjeve u instalua një sistem elektronik për identifikimin e zgjedhësve për të zbutur rrezikun e votimit të dyfishtë, votimit familjar ose të falsifikimit të identitetit të zgjedhësit. Përveç kësaj, pajisjet skanuan shenjat e gishtërinjve, të cilat mund të përdoren si prova në ankesa të mundshme. Një operator teknik, i caktuar nga KQZ-ja për çdo qendër votimi, ndihmoi me procesin e identifikimit të zgjedhësve. KQZ-ja u përball me një mungesë operatorësh teknikë jashtë qendrave kryesore urbane dhe me dorëheqje të minutës së fundit.

²⁶ Shih nenin 26 të [ICCPR](#). Paragrafi 5.9 i [Dokumentit të Kopenhagenit i vitit 1990 i OSBE-së](#) thotë se: “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtën e mbrojtjes me ligj pa asnjë lloj diskriminimi”. MKVZ-ja e ODIHR-it u informuar se 2,861 zgjedhës me moshë mbi 100 vjeç ishin hequr nga regjistri i zgjedhësve, kurse 446 ishin lënë në listën përfundimtare të zgjedhësve.

²⁷ Sipas Ministrisë së Brendshme, janë rreth 800,000 votues me dokumente identiteti të skaduar. Në muajin mars, qeveria e shtyu afatin e vlefshmërisë së dokumenteve të identitetit deri më 30 prill 2021 për të garantuar pjesëmarrjen e votuesve që u kishin skaduar këto dokumente.

²⁸ Sipas [Institutit Shqiptar të Statistikave](#) (INSTAT), numri i të ashtuquajturës “diaspora e re” në vitin 2020 llogaritej të ishte rreth 1.68 milion (37 për qind) e qytetarëve shqiptarë. Termi diasporë e re përdoret për ata që kanë emigruan pas viteve 1990.

²⁹ DPGjC-ja ka nisur të bëjë disa ndryshime në të dhënat e adresave të zgjedhësve, duke pretenduar se kjo nuk çoi në ndryshim të qendrës së votimit të zgjedhësve. Sipas ligjit, njoftimet e zgjedhësve duhet të bëhen deri në 60 ditë pas shpalljes së ekstraktit të listave të zgjedhësve. Ekstrakti i parë u publikua më 3 tetor 2020.

³⁰ Për ditën e zgjedhjeve u ngritën 20 qendra të posaçme votimi gjithsej. Për shkak të kufizimeve të vendosura për COVID-19, në spitale nuk u ngritën qendra të posaçme votimi.

³¹ Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar me COVID-19 në ditën e zgjedhjeve ishte rreth 23,000. Kjo praktikë bie ndesh përkatësisht me dispozitat për të drejtat e votimit dhe barazinë e votës parashikuar në nenin 45 të Kushtetutës dhe me paragrafin 7.3 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 të OSBE-së.

Politikat dhe rregullimet teknike dhe operacionale për identifikimin elektronik u miratuan vetëm disa javë para ditës së zgjedhjeve.³² Në përputhje me Kodin Zgjedhor, testi për funksionimin e tij u krye nga KQZ-ja nëntë ditë para ditës së zgjedhjeve me 3 për qind të pajisjeve të përdorura. Nuk u krye asnjë auditim i pavarur i procedurave dhe programit kompjuterik (software) përfundimtar. Ndonëse shumica e bashkëbiseduesve të MNVZ-së, duke përfshirë edhe të katër partitë më të mëdha politike, shprehën mbështetje për sistemin e identifikimit elektronik, kufizimet kohore, mungesa e mbikqyrjes publike dhe mungesa e një auditimi të paanshëm ua bëri të vështirë aktorëve të bënin një vlerësim të pavarur të procedurave përgatitore dhe të funksionimit si duhet të sistemit elektronik të identifikimit të zgjedhësve.³³

Regjistrimi i kandidatëve

Çdo zgjedhës me të drejtë vote ka të drejtë të kandidojë, përveç atyre që vuajnë aktualisht një dënim me burg ose që kanë qenë të dënuar më parë për vepra penale specifike, si dhe të atyre që deportohen nga vende të caktuara ose që janë objekt i një urdhri arresti.³⁴ Kufizimet ndaj personave të deportuar apo personave që janë objekt të një urdhri arresti, faji i të cilëve nuk është përcaktuar me vendim gjykatë, janë në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, mishëruar në instrumente ndërkombëtare kyçe të të drejtave të njeriut.³⁵ Kushtetuta rendit kategoritë e zyrtarëve, veprimtaria e të cilëve është e papajtueshme me të drejtën për të kandiduar.³⁶

Lista kandidatësh mund të dorëzohen nga partitë politike dhe nga koalicionet e partive, të cilat regjistrohen fillimisht në KQZ si subjekte zgjedhore. Duhet të paraqitet një listë për secilën prej 12 zonave zgjedhore.³⁷ Kandidatët e pavarur mund të garojnë përmes nominimit nga një grup zgjedhësish.³⁸ Një kandidat mund të paraqitet vetëm në një listë. Ndryshimet ligjore të 2020-ës parashikojnë një përjashtim nga ky rregull për kryetarët e partive, të cilëve u lejohet të kandidojnë deri në katër zona zgjedhore, por nëse zgjidhen, ata mund të mbajnë vetëm njërin mandat, atë që zgjedhin vetë. Kjo shkel të drejtën e kandidimit në kushte të barabarta (shih *Kuadrin Ligjor dhe Sistemin Zgjedhor*). Nga momenti që një kandidat regjistrohet, lista e kandidatëve nuk mund të ndryshohet më.

Në secilën listë, duhet të emërohet të paktën një e treta e kandidatëve nga secila gjini. Kodi Zgjedhor i përcakton efektivisht gratë si gjininë më pak të përfaqësuar.³⁹ Duke qenë se Kodi është i paqartë për mënyrën e radhitjes së grave në listat e kandidatëve, KQZ-ja e interpretoi në mënyrë të tillë që të paktën

³² Nuk u bë asnjë pilotim për sistemin e identifikimit elektronik të zgjedhësve. Sipas praktikave më të mira për futjen e teknologjisë në procesin zgjedhor, ato duhet të futen gradualisht përmes pilotimeve të kufizuara. Kjo lejon adresimin e risqeve dhe sfidave para futjes së teknologjive të tilla në përdorim të plotë.

³³ [Udhëzuesi i ODIHR-it për Vëzhgimin e Teknologjive të Reja të Votimit](#) shpjegon “Mënyra graduale e futjes në përdorim të teknologjive të reja të votimit, së bashku me testimin, verifikueshmërinë dhe transparencën e plotë, mund të ndihmojnë në krijimin e besimit të publikut [te teknologjitë e reja të votimit]”.

³⁴ Ligji i Dekriminalizimit i referohet deportimit nga vendet anëtare të BE-së, Australia, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara. Ai i referohet, gjithashtu, edhe shtetasve të dënuar për krime të caktuara.

³⁵ Shih nenin 16 (2) të [ICCPR](#) dhe nenin 6 (2) të [KEDNJ](#). Paragrafi 5.19 i [Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 të OSBE-së](#) thotë se “çdo njeri duhet të prezumohet i pafajshëm derisa të shpallet fajtor sipas ligjit”.

³⁶ Gjykatësit, prokurorët, ushtarakët, policët dhe oficerët e sigurisë kombëtare, përfaqësuesit diplomatikë, kryetarët e bashkive, prefektët, kryetarët dhe anëtarët e komisioneve zgjedhore, Presidenti i Republikës, zyrtarët e lartë të administratës shtetërore të përcaktuara me ligj.

³⁷ Listat e kandidatëve duhet të mbështeten me firmat e 5,000 zgjedhësve për partitë ose 7,000 zgjedhësve për koalicionet në të gjithë vendin. Zgjedhësit mund të mbështesin disa lista njëherësh. Ky kusht nuk vlen për partitë parlamentare dhe për koalicionet, ku partitë pjesëmarrëse mbajnë të gjitha bashkë një numër mandatesh parlamentare jo më të vogël se numri i këtyre partive.

³⁸ Grupet e votuesve duhet të përbëhen nga të paktën nëntë zgjedhës dhe të regjistrohen në KQZ për të mbledhur firmat e një përqind të zgjedhësve në zonën zgjedhore përkatëse, por jo më shumë se 3,000. Kandidatët e pavarur janë të përjashtuar nga ky detyrim nëse kanë deputetë.

³⁹ Shih nenin 2(26) të Kodit Zgjedhor. Ky formulim në ligj lejon që listat të përbëhen edhe vetëm nga kandidatë gra. Kjo mundësi nuk u jepet burrave, gjë që mund të perceptohet si diskriminuese.

një në çdo tre kandidatë (duke filluar me numrin një), të jetë grua. Numri i kandidatëve në listë nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve të caktuara në zonë zgjedhore në parlament dhe mund të rritet me deri në dy mandate.⁴⁰ Kodi nuk shprehet qartë nëse ka një kufi të sipërm për numrin e kandidatëve në listë. Më 18 mars, Komisioneri nuk e pranoi regjistrimin e 69 kandidatëve gjithsej të propozuar nga koalicioni i PD-së-Aleanca për Ndryshim, me arsyetimin se këto propozime tejkalonin kufirin e sipërm “të nënkuptuar”. KAS-i e hodhi poshtë vendimin e Komisionerit; megjithatë, më 30 mars, Kolegji Zgjedhor e la vendimin e Komisionerit në fuqi, duke zbatuar efektisht në këtë mënyrë një kufi të sipërm për numrin e lejueshëm të kandidatëve për listë.⁴¹

Kandidaturat verifikohen nga KQZ-ja në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe me Ligjin e Dekriminalizimit.⁴² Para regjistrimit të listave nga KQZ-ja, kandidatët e paraqitur që konstatohet se nuk e kanë të drejtën e kandidimit hiqen nga listat dhe KQZ-ja u jep mundësinë partive që t'i zëvendësojnë. Nëse, pas regjistrimit të listave, dalin informacione të reja që duhet të çojnë në skualifikimin e një kandidati, kandidati vazhdon të qëndrojë në listë, por nuk mund ta marrë mandatin nëse zgjidhet.⁴³ Procesi i skualifikimit dhe heqjes së mandatit është një proces që mund të ndodhë në çfarëdo momenti të ciklit zgjedhor.

Regjistrimi i kandidatëve dhe partive ishte gjithëpërfshirës. KQZ-ja regjistroi 10 parti politike dhe 2 koalicione për të garuar në të gjithë vendin, si dhe 5 kandidatë të pavarur për të garuar në 5 qarqe.⁴⁴ Në total, u regjistruan 1,871 kandidatë, duke përfshirë 732 gra (40 për qind).

Mjedisi i fushatës

Fushata zgjedhore filloi zyrtarisht më 26 mars.⁴⁵ Zgjedhësve iu prezantuan një sërë koalicionesh, partish dhe kandidatësh të pavarur si mundësi zgjedhjeje.⁴⁶ Fushatës politike i mungoi dinamika, duke qenë se mesazhet fokusoheshin shpesh te drejtuesit kryesorë të partive dhe jo te diskutimet me në qendër problemet e vërteta. Në realitet, elektoratit iu prezantua si mundësi zgjedhjeje nga njëra anë vazhdimësia dhe një qeveri e drejtuar nga PS-ja dhe nga ana tjetër ndryshimi, përmes dakordësimit të një koalicioni të planifikuar PD-LSI.⁴⁷ Tonet e gjuhës së përdorur gjatë fushatës nga disa drejtues partish dhe veçanërisht nga Presidenti, ishin konfrontuese dhe në disa raste shumë të nxehta.⁴⁸

⁴⁰ Interpretimi nga ana e KQZ-së për shprehjen ‘deri në dy’ ka për qëllim të garantojë që në çfarëdo rrethanash, numri i kandidatëve të propozuar në listë të jetë i pjesëtueshëm me tre, me qëllim që të funksionojë për kuotën gjinore.

⁴¹ Si rrjedhojë e këtij vendimi, krijohet mundësia që të ketë një numër të pamjaftueshëm kandidatësh rezervë për të plotësuar vendet vakante; ky risk prek veçanërisht zonat me numër më të vogël mandate. Kjo çështje u ngrit nga shumë aktorë.

⁴² Secili kandidat duhet të paraqesë një formular vetëdeklarimi mes dokumenteve të tjera në mbështetje të kandidaturës së tyre. Procesi i verifikimit nga KQZ-ja kryhet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (Zyra e Gjendjes Gjyqësore) dhe me Zyrën e Gjendjes Civile.

⁴³ KQZ-ja mund t'i dërgojë emrat e kandidatëve të prekur në Prokurorinë e Përgjithshme (PP) për hetime të mëtejshme. Në total, dokumentet e 30 kandidatëve nga 10 subjekte zgjedhore iu dërguan PP-së, duke përfshirë edhe kandidatë nga PS-ja, PD-ja dhe nga PSD-ja. Deri më 23 prill, procesi i verifikimit për 27 kandidatë ishte ende në vazhdim.

⁴⁴ Pesë kandidatë të pavarur garuan në Dibër, Gjirokastrë, Lezhë, Shkodër dhe Tiranë. KQZ-ja refuzoi dy lista – atë të koalicionit të *Aleancës* – me arsyetimin se disa parti ishin larguar nga koalicioni para se të regjistroheshin dhe një listë të Partisë Aleanca Kombëtare që nuk përmbushte kriteret.

⁴⁵ Sipas Kodit Zgjedhor, fushata zgjedhore fillon zyrtarisht 30 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe mbaron 24 orë para ditës së zgjedhjeve. PS-ja dhe koalicioni *Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim* (PD-Koalicioni i Aleancës) që të dyja i nisën fushatat më 25 mars.

⁴⁶ Koalicioni i udhëhequr nga PD-ja përfshinte PD-në bashkë me 12 parti më të vogla në një koalicion me bazë të gjerë, duke përfshirë edhe Partinë Republikane (PR), PDIU-në dhe Partinë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ).

⁴⁷ PD-ja dhe Koalicioni i udhëhequr prej saj, së bashku me LSI-në nuk u regjistruan si koalicion, por bënë marrëveshje politike për të bashkëpunuar në formimin e qeverisë, nëse zgjidhen.

⁴⁸ Komisioneri u [bëri thirrje](#) palëve që të demonstrojnë vetëpërmbytje dhe të shmangin gjuhën e ashpër gjatë fushatës.

Platforma e PS-së u fokusua tek programi i vaksinimit për COVID-19 dhe tek arritjet e qeverisë, duke përfshirë rindërtimin në vazhdim e sipër pas tërmetit të vitit 2019. Koalicioni i drejtuar nga PD-ja dhe LSI-ja u fokusuan te tema qendrore e kundërvënies ndaj pushtetit tejet të centralizuar të Kryeministrit Edi Rama.⁴⁹ Opozita u fokusua, gjithashtu, edhe në fushatën e saj edhe tek ekonomia, stimujt financiarë për të rinjtë dhe fermerët, pagat dhe punësimi. Të gjitha partitë patën të përbashkët aderimin e vendit në BE.

PD-ja dhe PS-ja, që të dyja të drejtuara nga meshkuj, kanë tentuar të rrisin vizibilitetin e kandidatëve femra, siç ka bërë edhe LSI-ja, e cila drejtohet nga një grua.⁵⁰ Që të gjitha partitë e mëdha dhe koalicionet bënë propozime fushate e mesazhe për zgjedhëset femra, megjithëse shumë prej bashkëbiseduesve të MNVZ-së shprehën dyshime sa i përket vërtetësisë së këtyre përpjekjeve.

Liritë themelore u respektuan dhe subjektet zgjedhore patën që të gjitha mundësi të bënin fushatë në mënyrë të lirë. Fushata u zhvillua kryesisht përmes rrjeteve sociale, takimeve publike dhe takimeve derë-më-derë. Postera promocoionale u lejuan vetëm në vendet e caktuara për këtë qëllim. Kishte kufizime të vendosura për shkak të pandemisë së COVID-19, duke përfshirë kufizimet për tubimet, kriteret e distancimit dhe përdorimi i maskave të fytyrës, të cilat krijuan vështirësi dhe e zbehën fushatën për të gjithë garuesit.⁵¹ Vendosja e gjobave dhe masave të tjera për shkeljen e rregullave lidhur me COVID-19 nuk u aplikuan në mënyrë konsistente. Mosrespektimi i rregulloreve të COVID-19 gjatë pjesës më të madhe të aktiviteteve u tolerua.⁵² Në raste të tjera, u vendosën sanksione, me gjoba që preknin kandidatët e pavarur në mënyrë joproporcionale dhe që sillnin pasiguri.⁵³

Akuzat për shitblerje votash ishin konstante gjatë fushatës, duke treguar se ky vazhdoi të përbente një problem gjerësisht të përhapur.⁵⁴ PD-ja përdori disa metoda ndërhyrjesh, të vetë-justifikuara në deklaratat e saj publike, për t'iu kundërvënë aktiviteteve të pretenduara të shitblerjes së votave.⁵⁵

Kuadri ligjor e ndalon shpërdorimin e burimeve administrative, ul avantazhet e kandidatëve që garojnë ndërkohë që janë në pushtet dhe kufizon shpenzimet buxhetore gjatë periudhës katër-mujore para

⁴⁹ Disa parti opozitare e bënë të qartë se problemi i tyre kryesor ishte z. Rama dhe jo PS-ja. Nga të gjitha partitë opozitare u ngritën vazhdimisht akuza për korrupsion, shpërdorim të burimeve shtetërore dhe për lidhje me krimin e organizuar.

⁵⁰ Për shembull, në nisjen e fushatës së PS-së, 11 nga 14 fjalime gjithsej [u mbajtën nga kandidatë gra](#). Drejtuesi i PD-së prezantoi një [program për barazinë gjinore](#). Në listën e kandidatëve të LSI-së, gjysmën e zinitin gratë.

⁵¹ Kufizimet e përkohshme përfshinin kufirin prej maksimumi 10 vetësh në takime sipas Urdhrit Nr. 633/2020 të Ministrit të Shëndetësisë. Ky urdhër u konfirmua nga Gjykata Kushtetuese, e cila shprehu gjithsesi rezerva në lidhje me kohëzgjatjen e pacaktuar të masave.

⁵² Në Tiranë, Kryetari i Bashkisë e udhëzoi policinë të mos u vinte gjoba kandidatëve. Po kështu e udhëzoi edhe Kryeministri policinë në shkallë vendi.

⁵³ Dy nga pesë kandidatë të pavarur u gjobitën: në qarkun e Dibrës, policia e qarkut i vuri një kandidati një gjobë prej 5 milion lekësh (afërsisht 40,000 Euro) për adresimin e afërsisht 100 mbështetësve. Edhe në Lezhë, një kandidati që kandidonte nën banerin e Vetëvendosjes iu vu një gjobë prej 5 milion lekësh nga policia. 1 Euro është afërsisht 123 lekë.

⁵⁴ Struktura e Posaçme e Anti-Korrupsionit (SPAK) e informoi MKVZ-në e ODIHR-it se deri më 24 prill 2021, kishte hapur më shumë se 30 çështje që lidheshin me shitblerjen e votës. MKVZ-ja e ODIHR-it u informua, gjithashtu, nga prokurorë të Beratit dhe të Shkodrës se kishin nisur hetimet për disa incidente të shitblerjes së votës. PD-ja depozitoi një ankesë në Strukturën e Posaçme Anti-Korrupsionit (SPAK) që përmbante dhjetëra akuza për incidente shitblerjeje të votës në Elbasan.

⁵⁵ Më 21 prill, një person u vra dhe tre u plagosën në një incident me të shtëna armësh në Elbasan. PD-ja formoi një grup të quajtur “Struktura për Mbrojtjen e Votës”, [duke u shprehur se](#) ajo përbëhej nga ish anëtarë të policisë së shtetit, të cilëve PD-ja u kishte kërkuar të “verifikonin” informacionet e marra lidhur me shitblerjen e votave; [Policia e Elbasanit](#) arrestoi 10 persona të dyshuar për privim të paligjshëm të lirisë me forcë dhe deklaroi se disa prej tyre kishin qenë të armatosur. Policia ndërmori gjithashtu masa edhe ndaj “Strukturës për Mbrojtjen e Votës” në qarkun e [Dibrës](#) dhe të [Korçës](#), më 23 prill.

zgjedhjeve.⁵⁶ KQZ-ja ka një faqe zyrtare, ku qytetarët mund të denoncojnë shkeljet zgjedhore.⁵⁷ Përpjekjet e KQZ-së për dërgimin e 64 monitoruesve të fushatës për të mbikëqyrur respektimin e rregullave dhe rregulloreve ishin për t'u përgëzuar. Raportet e monitoruesve u publikuan në faqen e saj zyrtare, por ishin të kufizuara sa i përket objektit, analizimit dhe qartësisë, gjë që ua zbehu dobinë.⁵⁸

Kodi Zgjedhor kërkon që angazhimet zyrtare brenda katër muajsh para ditës së zgjedhjeve të raportohen të paktën pesë ditë para në KQZ.⁵⁹ Ministrat vazhduan me angazhimet e tyre zyrtare gjatë gjithë fushatës. Ata u shfaqën rregullisht në “vizita inspektimesh” të objekteve kyçe, si në qendrat e vaksinimit, me maska në fytyrë ose me bluza që lexonin “Nr. 12” (numri i PS-së në fletën e votimit), gjë që çoi në publicitet të konsiderueshëm dhe që përbëri aktivitet për qëllime fushate. Edhe Kryeministri inauguroi disa projekte madhore infrastrukturore gjatë fushatës zgjedhore.⁶⁰ Këto lloj aktiviteteve i dhanë një avantazh të konsiderueshëm PS-së, gjë që ishte përforcuar tashmë edhe më shumë nga dominimi i PS-së në administratën lokale. Përveç kësaj, punësimi në sektorin publik u rrit ndjeshëm në periudhën parazgjedhore, saktësisht në kohën para moratoriumit ndaj autorizimit të punësimeve të reja në administratën publike.⁶¹

Gjatë fushatës, përmes një rrjedhjeje informacioni, në domeinin publik doli një databazë me informacione personale dhe detaje kontakti për afërsisht 900,000 qytetarë shqiptarë, që përmbante edhe preferencat e tyre potenciale të votimit.⁶² Partitë opozitare, Presidenti dhe shumë të tjerë në media bënë thirrje për hetim nga SPAK-u të këtij shpërdorimi të pretenduar të të dhënave personale të qytetarëve.⁶³ Disa bashkëbisedues të MNVZ-së nga partitë kryesore politike besonin se një incident i tillë mund të konsiderohej nga elektorati si shpërdorim i të dhënave personale për interesa të partive.

⁵⁶ [Vendimi Nr. 9 i Rregullatorit](#) parashikon *inter alia* se në katër muajt para ditës së zgjedhjeve, aktivitetet e ndaluara përfshijnë shpërndarjen e lejeve të legalizimit, regjistrimin e titujve të pronësisë, përdorimin në fushatën zgjedhore të burimeve të administratës shtetërore qendrore dhe lokale, përdorimin e nxënësve para-universitarë, marrjen në punë apo pushimin nga puna të stafit të institucioneve publike; përveç kësaj, nuk duhet të ketë akte që ofrojnë rritje të rrogave, pensioneve, mbështetjes financiare apo sociale, reduktim apo heqje të taksave, përjashtim nga gjokat/taksat, apo privatizim; përdorimi i burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore kontrollohen rreptësisht.

⁵⁷ Janë vënë në dispozicion si aplikacioni për smartphone, ashtu edhe një [version për faqe interneti](#).

⁵⁸ Shumë prej raporteve ishin dokumente me shkrim dore. Nga 63 raporte të paraqitura gjatë javës së parë, 6 identifikonin parregullsi që lidheshin kryesisht me vendndodhjen e zyrave të fushatës ose me posterat. Në një raport identifikohesh mosraportimi i aktiviteteve me natyrë publike nga organet publike, por pa shumë detaje. KQZ-ja nuk u kërkoi monitoruesve të vet që të monitoronin financat e fushatës. Shih *Financimi i Fushatës*.

⁵⁹ Informacionet rreth aktiviteteve të planifikuara duhet të paraqiten përmes [faqes zyrtare të KQZ-së](#). Më pas, Komisioneri duhet t'i mbikëqyrë dhe ta identifikojë çdo aktivitet të ndaluar; në këtë rast ato nuk duhet të mbulohen në media. Më 24 mars, Komisioneri u shkroi të gjitha ministrave, si dhe të gjitha bashkive, si dhe u bëri thirrje titullarëve të institucioneve publike që të kufizohen dhe të përmbushnin detyrimet e tyre në lidhje me ndalimin e përdorimit të burimeve shtetërore në mbështetje të subjekteve zgjedhore.

⁶⁰ KQZ-ja duhet të mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e mbajtura nga institucionet publike për të parë nëse ka shpërdorime të burimeve publike; megjithatë, gjatë të gjithë fushatës zgjedhore, asnjë aktivitet i paraqitur paraprakisht nuk u identifikua si i ndaluar. Është e paqartë nëse KQZ-ja e ka krijuar tashmë kapacitetin institucional për t'i analizuar dhe për t'i shqyrtuar me efikasitet të gjitha deklaratimet e detyrueshme të aktiviteteve zyrtare.

⁶¹ Moratoriumi ligjor ndaj autorizimit të punësimeve të reja filloi më 25 dhjetor 2020. Sipas Institutit Shqiptar Kombëtar të Statistikave (INSTAT), midis tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020, punësimi në sektorin publik është rritur me 6 për qind (nga 171,975 deri në 182,547). Rritja në të njëjtin tremujor në vitin 2018 dhe 2019 ishte përkatësisht 1 dhe 0 për qind. Më 24 dhjetor, qeveria autorizoi edhe 2,472 pozicione të tjera.

⁶² Ekzistenca e kësaj databaze në domeinin publik u konfirmua në mënyrë të pavarur nga MKVZ-ja e ODIHR-it.

⁶³ Presidenti bëri thirrje për një “hetim për shpërdorimin e të dhënave personale të qytetarëve shqiptarë dhe të bazës shtetërore të të dhënave nga Partia Socialiste”. SPAK konfirmoi për MKVZ-në e ODIHR-it se tashmë për këtë ka nisur një hetim.

MKVZ-ja e ODIHR-it mori edhe raportime për përpjekje të bëra për ndikim të votës përmes ofrimit të stimujve.⁶⁴ Në këto raporte pretendohet, gjithashtu, se shumë nëpunës civilë, një grup i punësuar që është vulnerabël ndaj presioneve, janë inkurajuar të votojnë për partinë qeverisëse.

Financimi i Fushatës

Financimi i fushatës rregullohet kryesisht nga Kodi Zgjedhor. Në nëntor të vitit 2020, Ligji për Partitë Politike u ndryshua, duke iu hequr dispozitat për financimin e fushatave dhe duke hequr në këtë mënyrë edhe mospërputhjet me Kodin Zgjedhor. Më 6 prill, 12 ditë pas fillimit të fushatës, Rregullatori miratoi rregullat, procedurat dhe formularët e gatshëm për raportimet përfundimtare të garuesve lidhur me dhurimet dhe shpenzimet, si dhe mbi mbikqyrjen e financimit të fushatës; më 14 prill u miratuan edhe disa udhëzime dhe formularë të tjerë shtesë. Miratimi i rregulloreve të detyrueshme në një fazë të avancuar të procesit zgjedhor krijon paqartësi të panevojshme dhe mund të ndikojë negativisht në aktivitetin e fushatës së garuesve⁶⁵.

Partitë politike që kanë garuar në zgjedhjet e fundit parlamentare marrin fonde publike për aktivitetet e tyre të zakonshme.⁶⁶ Partitë që kanë marrë të paktën 1 për qind të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare marrin gjithashtu fonde publike për fushatë, në raport të drejtë me numrin e votave të fituara.⁶⁷ Kandidatët e pavarur nuk kanë të drejtë të marrin fonde publike. Garuesit mundet, gjithashtu, t'i financojnë fushatat e tyre me fondet e veta, me donacione nga shtetas shqiptarë dhe nga persona juridikë, si dhe me kredi bankare.⁶⁸ Donacionet, duke përfshirë edhe ato në natyrë, kanë një kufi prej 1 milion lekësh (afërsisht 8,130 Euro).⁶⁹ Kontributet prej më shumë se 50,000 lekësh duhet të bëhen përmes një llogarie bankare të caktuar për këtë qëllim. Totali i shpenzimeve të fushatës së një partie nuk mund të tejkalojë shumën prej 167,480,000 lekësh; shpenzimet e kandidatëve të pavarur nuk mund të tejkalojnë shumën prej 27,913,000 lekësh.

Sipas ligjit, KQZ-ja mbikëqyr respektimin e rregulloreve për financimin e fushatës. Megjithëse Kodi Zgjedhor kërkon që monitoruesit e KQZ-së të raportojnë mbi financimet e fushatave, deri më 23 prill, raportet e tyre nuk përmbanin asnjë evidencë të mbledhur në mënyrë metodike lidhur me aktivitetin financiar të garuesve.⁷⁰ KQZ-ja është e autorizuar të vendosë sanksione për mosrespektim të rregullave përkatëse, por nuk është vendosur asnjë sanksion i tillë.

⁶⁴ Këtu futet edhe lëshimi i lejeve për legalizim.

⁶⁵ MKVZ-ja e ODIHR-it vuri re në disa zona zgjedhore se disa kandidatë nuk ishin në dijeni të kërkesave për raportimin e financimit.

⁶⁶ Buxheti i caktuar për vitin 2021 është 140 milion lekë (afërsisht 1,138,000 Euro). Në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të 2017-ës, fonde iu dhanë gjashtë partive: PS – 45.3 për qind, PD– 27.8 për qind, LSI – 14.3 për qind, PDIU – 5.3 për qind, PSD – 3.8 për qind, kurse Listës së Barabartë (LIBRA) – 3.5 për qind.

⁶⁷ PS-ja mori rreth 55,8 milion lekë; PD-ja - 31,5 milion; LSI-ja - 18,9 milion; PDIU - 4,5 milion; Partia Fryma e Re Demokratike - 2,1 milion; PR-ja - 1,8 milion; PSD-ja - 1,6 milion; Partia Bindja Demokratike - 1,4 milion; Partia Kristian Demokratike - 1,4 milion, kurse Lëvizja për Zhvillim Kombëtar - 1,4 milion. Ndryshimet e vitit 2020 e kufizuan aksesin në fondet publike për fushatë nga të gjitha partitë që kishin garuar në zgjedhjet e mëparshme tek ato që kanë fituar të paktën një për qind të votave.

⁶⁸ Subjektet juridike që kanë marrë fonde nga prokurimi publik që tejkalojnë shumën prej 10 milion lekësh, që janë përfshirë në projekte partneritetesh publik-privat, që kanë detyrime ndaj buxhetit të shtetit, si dhe ato që zhvillojnë aktivitete mediatike, nuk lejohet të dhurojnë.

⁶⁹ Më 24 dhjetor 2020, Rregullatori miratoi disa rregulla për llogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë. Financimi nga palë të treta nuk është i rregulluar me ligj.

⁷⁰ Vendimi i Rregullatorit kërkon që monitoruesit e KQZ-zë të paraqesin raporte të ndërmjetme çdo 10 ditë që nga fillimi i punës së tyre, si dhe një raport përfundimtar brenda 7 ditësh pas ditës së zgjedhjeve. Përveç kësaj, nëse vërehet një shkelje konkrete, kërkohet gjithashtu të bëhen të ashtuquajturat “raporte incidentesh”. Këto raporte duhet të publikohen në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së brenda dy ditësh nga paraqitja e tyre. KQZ-ja konfirmoi se monitoruesit nuk ishin trajnuar për mënyrën e monitorimit të respektimit të rregullave dhe rregulloreve për financimin e fushatës.

Garuesve në zgjedhje u kërkohet të paraqesin raporte financiare vetëm pas zgjedhjeve, brenda 60 ditësh nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve, kurse KQZ-ja duhet të caktojë auditues për shqyrtimin e këtyre raporteve. Gjetjet e audituesve duhet të publikohen brenda 30 ditësh nga dorëzimi i tyre. Mungesa e një kërkese ligjore për raportim të ndërmjetëm gjatë fushatës mbi burimin dhe shumën e fondeve të mbledhura e kufizon transparencën e financimit të fushatës dhe ul mundësinë e bërjes së zgjedhjeve të informuara nga zgjedhësit të bazuar tek informimi mbi burimet e fondeve të fushatës.⁷¹

Media

Mjedisi i ngarkuar mediatik vepron në kushtet e një tregu të kufizuar reklamash, i përqendruar mes një numri të vogël organesh mediatike. Këto të fundit shërbejnë shpesh si platforma lobimi për pronarët e tyre, duke sfiduar kështu pavarësinë editoriale dhe duke nxitur auto-censurën. Shumë prej bashkëbiseduesve të MNVZ-së u shprehën se, në mungesë të një vetërregullimi efikas dhe në një situatë kushtesh të pasigurta pune, gazetarët mbeten vulnerabël ndaj presionit dhe korrupsionit. Disa bashkëbisedues të MNVZ-së ngritën shqetësime rreth sigurisë dhe ndjekjes ligjore të gazetarëve.⁷² Televizioni mbetet burimi kryesor i informacioneve politike.⁷³

Kushtetuta garanton lirinë e shprehjes, lirinë e medias, të drejtën e informimit dhe ndalon censurimin e mjeteve të komunikimit. Ndonëse shpifja është e dënueshme vetëm me gjobë, ajo vazhdon të parashikohet si vepër penale, pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it.⁷⁴ Mbulimi i fushatave në mediat audio-vizuale rregullohet në mënyrë të hollësishme nga Kodi Zgjedhor.⁷⁵ Dispozitat për mundësitë e mbulimit falas të fushatës në stacionin e televizionit publik RTSH sigurojnë shikueshmëri minimale për të gjithë garuesit zgjedhorë.⁷⁶ Megjithatë, mungesa e një kërkese minimale

⁷¹ Neni 7.3 i Konventës së vitit të 2003 të OKB-së, [UNCAC](#), rekomandon që shtetet të ndërmarrin masa legislative dhe administrative “për të rritur transparencën e financimit të kandidatave për poste të zgjedhura publike”. Paragrafi 247 i [Udhëzimeve të Përbashkëta të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për Rregullimin e Partive Politike të vitit 2020](#) thotë se “Zgjedhësit duhet të kenë informacione relevante sa i përket mbështetjes financiare që u jepet partive politike, pasi kjo ndikon në vendimmarrje dhe është një mënyrë për t’i bërë partitë që të japin llogari”.

⁷² Në muajin prill, pati dy incidente përplasjesh fizike të filmuara ndaj gazetarëve të Ora News nga badigardët e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj dhe nga mbështetësit e tij në Kavajë, kur gazetarët u përpoqën të intervistonin kryetarin e bashkisë. Gjithashtu, komuniteti i gazetarëve ngriti shqetësime rreth hetimit të pronarëve të një faqeje informative në internet, e cila ishte e para që raportoi rrjedhjen e bazës së të dhënave personale të qytetarëve të Tiranës. Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias [ka ngritur shqetësime](#) në lidhje me intimidimin dhe sulmet ndaj gazetarëve, të cilat minojnë sigurinë e tyre.

⁷³ Organet më popullore mediatike online janë të lidhura me televizionet dhe dublojnë përmbajtjen e tyre. Media e shkruar vështirë se është e përfaqësuar dhe është zhvendosur kryesisht online. Të dhënat për tirazhin nuk janë të disponueshme publikisht.

⁷⁴ Paragrafi 47 i [Komentit të Përgjithshëm 34 të CCPR të vitit 2011 në ICCPR](#) kërkon që “Ligjet e shpifjes të hartohen me kujdes për t’u siguruar që ato ... të mos shërbejnë, në praktikë, për të frenuar lirinë e shprehjes”.

⁷⁵ Radioja dhe televizioni publik duhet ta mbulojnë fushatën në mënyrë të paanshme, gjithëpërfshirëse, të vërtetë dhe të garantojnë pluralizmin e informacionit. Mediat audio-vizuale private duhet t’i përgatisin lajmet në liri të plotë editoriale. Transmetuesve u kërkohet të ofrojnë minutazh të barabartë për mbulimin e partive që kanë më shumë se 20 për qind të mandateve në parlament. Secila prej partive të tjera parlamentare merr gjysmën e kësaj kohe, kurse mbulimi i partive joparlamentare që garojnë në zgjedhje është në diskrecionin e redaktorëve dhe nuk mund të tejkalojë mbulimin që u jepet partive më të vogla parlamentare. Çdo parti parlamentare që garon në zgjedhje mund të blejë deri në 90 minuta, kurse partitë joparlamentare dhe kandidatët e pavarur mund të blejnë në total 10 minuta nga çdo transmetues privat radio-televiziv. Përveç minutazhit të blerë nga subjektet zgjedhore për reklamë, transmetuesve u kërkohet të ofrojnë falas gjysmën e minutazhit të blerë në total.

⁷⁶ RTSH-ja u ofroi subjekteve zgjedhore akses falas në studiot e saj të regjistrimit. Hedhja e shortit për caktimin e datës dhe radhën e paraqitjes së spoteve falas të reklamave u zhvillua nga RTSH më 30 mars. Megjithëse sipas ligjit, shorti duhet të hidhet nën mbikqyrjen e KQZ-së, në të nuk mori pjesë asnjë përfaqësues.

për mbulimin në edicionet informative të partive joparlamentare dhe të kandidatëve të pavarur e ngushton aksesin e tyre në media.⁷⁷

Vetëm 1 organ mediatik i shkruar/online dhe 10 nga më shumë se 100 radio dhe televizione private, kanë dorëzuar në KQZ listat e tyre të çmimeve për reklamat e fushatave në përputhje me ligjin, kështu që transparenca e kushteve të reklamave ishte e kufizuar.

Autoriteti i Medias Audio-Vizuale (AMA) monitoroi respektimin e rregullave nga transmetuesit dhe paraqiti raporte ditore dhe javore në KQZ, të cilat u publikuan në faqen zyrtare të KQZ-së.⁷⁸ Monitorimi i kufizua tek analizimi sasior dhe nuk përfshiu një vlerësim të tonit të mbulimit. Shumë bashkëbisedues të MKVZ-së së ODIHR-it vunë në pikëpyetje kapacitetin e AMA-s për kryerjen e një mbikqyrjeje të mjaftueshme.⁷⁹ Gjetjet e AMA-s treguan se PS-ja kishte marrë sistematikisht më shumë mbulim se subjektet e tjera. Disa transmetues i shpërfillën thirrjet e përsëritura të AMA-s dhe të KQZ-së për të kompensuar mbulimin e ulët të disa partive. Raportet treguan, gjithashtu, se kishte raste të shumta reklamash me pagesë në edicionet informative dhe përtej kohës së parashikuar me ligj.

Përmes një interpretimi të ngushtë të ligjit dhe të akteve të KQZ-së, transmetuesit nuk arritën të bëjnë një mbulim gjithëpërfshirës të të gjitha subjekteve garuese.⁸⁰ Praktika e përhapur mes partive kryesore politike për t'i furnizuar organet mediatike me filmime të regjistruara paraprakisht ose me filmime të drejtpërdrejta nga aktivitetet e fushatës, ku mediat shpesh zgjedhën të mos merrnin pjesë, e kufizuan mundësinë e zgjedhësve për të marrë informacione objektive gjatë fushatës. Disa bashkëbisedues të MKVZ-së informuan se partitë nuk i kishin informuar paraprakisht mediat për aktivitetet e fushatës.

Monitorimi i medias nga ana e MKVZ-së së ODIHR-it tregon se megjithëse nuk pati debate televizive mes drejtuesve të partive në kanalet e monitoruara televizive, mbulimi ishte i tejngopur me lajme nga aktualiteti dhe me debate televizive politike (*talk-show*). Organet mediatike kryesore u frenuan nga bërja e analizave të thelluara dhe u kufizuan në rolin e tyre thjesht tek përcimi i opinionëve, të cilave u mungonin diskutimet e qenësishme të platformave zgjedhore.⁸¹ Disa prej spoteve të reklamave zgjedhore nuk ishin të identifikuar qartë. Disa kanale vendosën banera fushate gjatë transetimit të programeve dhe filmave, kurse *Klan News* i transmetoi ato brenda edicioneve informative, në kundërshtim me ligjin.

⁷⁷ Paragrafi 20 i [Kodit të Praktikave të Mira të Komisionit të Venecias](#) për Çështjet Zgjedhore thotë se në përputhje me lirinë e shprehjes, duhet të hartohet një dispozitë ligjore për të garantuar që të ketë akses minimal në mediat audio-vizuale me pronësi private, sa i përket fushatës zgjedhore dhe reklamave për të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje.

⁷⁸ Më 23 mars, Komisionieri vendosi të ndajë minutazhin falas. Edhe pse PDIU kishte mandate në parlament, duke qenë pjesë e koalicionit, ajo u klasifikua si parti që nuk kishte të drejtën e minutazhit falas si partitë e tjera parlamentare. Megjithatë, gjatë javës së parë të fushatës, AMA e monitoroi PDIU-në si partitë e tjera parlamentare, kurse më 6 prill, i propozoi KQZ-së që t'ia kompensonte kohën PDIU-së. Duke qenë se KQZ-ja e shqyrtoi raportin më 13 prill, ajo vendosi që ta përjashtojë PDIU-në nga kompensimi i kohës falas për qëllim ekuilibrimi. Më 20 prill, KAS-i e hodhi poshtë vendimin e Komisionierit, duke i dhënë PDIU-së kompensim e kohës televizive.

⁷⁹ Shtatë anëtarët e AMA-s emërohen nga parlamenti për një mandat pesë-vjeçar, me të drejtën e rinovimit të mandatit vetëm një herë. Aktualisht, janë tre vende vakante, kurse mandati i kryetarit dhe i një anëtari tjetër kanë skaduar. Sipas [faqes zyrtare](#) të parlamentit, brenda afatit të shkurtit 2020 nuk ka pasur një numër të mjaftueshëm kandidatësh që të kenë shprehur interes për pozicionin e kryetarit.

⁸⁰ Transmetuesit e kufizojnë shpesh mbulimin e subjekteve në edicionet informative me kërkesat minimale ligjore për ndarjen e kohës. Përveç kësaj, në edicionet informative u përdorën edhe materiale të regjistruara ekskluzive ose transmetime të drejtpërdrejta nga televizionet për mbulimin e aktivitetëve në lajme, pasi kjo lejohet me ligj.

⁸¹ Më 26 mars, MKVZ-ja e ODIHR-it filloi monitorimin cilësor dhe sasior të pesë stacioneve televizive (*RTSH-1*, dhe katër kanale televizive private: *Top Channel*, *TV Klan*, *Vizion Plus* dhe *A2 CNN*) dhe dy faqe lajmesh online <http://www.panorama.com.al/> dhe <https://www.oranews.tv/>. MKVZ-ja e ODIHR-it ndoqi edhe përmbajtjen zgjedhore në rrjetet sociale.

PD-ja dhe PS-ja dominonin në mbulimin e lajmeve politike në të gjitha organet e monitoruara mediatike, ku PS-ja pati një mbulim prej 27 deri në 35 për qind, kurse PD-ja nga 26 deri në 32 për qind të këtij mbulimi.⁸² Partitë kryesore transmetuan spote fushate negative kundër njëra-tjetrës. Në kanalet e monitoruara, PS-ja u mbulua me tone më pozitive sesa PD-ja.⁸³ Përveç kësaj, në 9 për qind të programeve të monitoruara të lajmeve dhe aktualitetit, kandidati Rama mbulohej në cilësinë e tij si Kryeministër. PS-ja mori edhe 15 për qind mbulim shtesë përmes mbulimit të dedikuar ministrive dhe institucioneve të tjera publike. Kjo e ngushtoi informacionin e vënë në dispozicion të zgjedhësve rreth subjekteve zgjedhore, duke ua kufizuar mundësinë për të bërë zgjedhje të informuara.

Megjithëse medias i kërkohet nga KQZ-ja që të ofrojë mbulim të barabartë gjinor, kjo e para nuk ka asnjë lloj kontrolli mbi vendimet e partive se kë propozojnë të marrë pjesë në programet televizive. Sipas monitorimit të MKVZ-së së ODIHR-it, kandidatet femra dhe aktorë të tjerë morën 39 për qind të mbulimit në programet informative dhe ato të aktualitetit.

Ankesat dhe apelimet

Kodi Zgjedhor parashikon një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore, me një procedurë të hollësishme për ankesat administrative dhe me garancitë e nevojshme për procesin. Megjithatë, ligji nuk e parashikon qartë gjykimin e ankesave në komisione të niveleve më të ulëta, duke e lënë të paqartë se cili është organi përgjegjës për ankesat në lidhje me shkeljet gjatë fushatës dhe shkeljet e procedurave në ditën e zgjedhjeve.⁸⁴ Si rregull, ankesa mund të bëhen nga subjekte garuese, të cilave u janë prekur interesat e ligjshme; vëzhguesit mundet që të apelojnë vetëm nëse nuk u jepet akreditimi, kurse zgjedhësit kanë të drejtë të paraqesin ankesë vetëm në lidhje me përfshirjen e tyre në listat e zgjedhësve, ndryshe nga praktikat e mira zgjedhore.⁸⁵

Vendimet e Komisionerit dhe të KZAZ-së mund të apelojnë në KAS-in e sapokrijuar.⁸⁶ Vendimet e KAS-it, si dhe të Rregullatorit mund të apelojnë në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit (Kolegji Zgjedhor), i cili është organi më i lartë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore.⁸⁷ Megjithatë, në disa prej vendimeve të tij, KAS-i është shprehur se vendimet e tij janë objekt apeli në gjykatën administrative dhe jo në Kolegjin Zgjedhor, sipas procedurave dhe afateve të përgjithshme. Më 4 mars, Kolegji Zgjedhor mori një qëndrim të ngjashëm, pasi ai hodhi poshtë një apelim nga LSI-ja në lidhje me një sanksion të vendosur nga Komisioneri kundër Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, me arsyetimin se apelimet në lidhje me shkelje nga çdo person tjetër përveç subjekteve zgjedhore nuk janë në juridiksionin e tij.⁸⁸ Këto qëndrime nga KAS-i dhe nga Kolegji Zgjedhor duket se e ngushtojnë kuptimin e Kodit Zgjedhor, i cili parashikon një shqyrtim të specializuar dhe të përshpejtuar të

⁸² Nga koha që u takonte partive, 41 dhe 46 për qind iu dedikuan drejtuesve të tyre përkatës. Ndërkohë që LSI-ja mori mesatarisht 7 për qind në të gjitha kanalet e monitoruara, të gjitha subjektet e tjera morën në total 8 për qind.

⁸³ Ndonëse RTSH-ja u kushtoi pak a shumë kohë të barabartë partive kryesore, ajo e mbuloi qeverinë dhe institucionet publike me tone neutrale dhe pozitive.

⁸⁴ Përveç kësaj, MKVZ-ja e ODIHR-it vëzhgoi disa raste polemikash juridiksionale mes gjykatave nëse ankesat në lidhje me listat e zgjedhësve duhet të gjykoreshin nga gjykatat civile apo ato administrative. Pavarësisht polemikave mbi juridiksionin, gjykatat i pranuan të gjitha ankesat për të mos i privuar zgjedhësit nga e drejta e tyre për të votuar.

⁸⁵ Seksioni II.3.3.f i [Kodit të Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias](#) rekomandon që “Të gjithë kandidatët dhe të gjithë votuesit e regjistruar në zonat përkatëse duhet të kenë të drejtë të apelojnë. Një kuorum i arsyeshëm mund të vendoset për apelimet nga zgjedhësit në lidhje me rezultatin e zgjedhjeve”.

⁸⁶ KAS-i përbëhet nga pesë anëtarë të zgjedhur nga parlamenti për një mandat nëntë-vjeçar nga radhët e ish-gjyqtarëve, këshilltarëve të gjykatave më të larta, anëtarëve të KQZ-së, zyrtarëve të lartë or ekspertëve.

⁸⁷ Kolegji Zgjedhor përbëhet nga tetë gjyqtarë nga gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit, të zgjedhura përmes një shorti dhe të emëruar për një mandat katër-vjeçar në dhjetor të vitit 2020. Pesë gjyqtarë janë gra. Çështjet shqyrtohen nga një panel prej pesë gjyqtarësh.

⁸⁸ Pas këtij vendimi të Kolegjit Zgjedhor, LSI-ja u ankua në Gjykatën Administrative të Tiranës, e cila ka planifikuar ta shqyrtojë çështjen më 28 prill.

ankesave që lidhen me zgjedhjet. Kolegji Zgjedhor ka dhjetë ditë kohë që nga depozitimi i ankesës e deri në zgjidhjen e saj. Ky afat i zgjatur mund edhe ta vonojë procesin zgjedhor.⁸⁹

Deri më 23 prill, Komisioneri mori 116 ankesa të depozituara në KQZ përmes portalit në faqen e tij zyrtare për raportimet rreth shkeljeve në lidhje me zgjedhjet.⁹⁰ MKVZ-ja e ODIHR-it u informua për nëntë raste, ku Komisioneri ka vendosur sanksione ose masa paralajmëruese; pjesa më e madhe e ankesave të tjera nuk janë pranuar ose janë pushuar, nga të cilat shumica për mungesë provash. Në KAS janë depozituar 23 apelime.⁹¹ Mbi këto baza, KAS-i hodhi poshtë gjashtë vendime të Komisionerit dhe tetë vendime të KZAZ-ve; dy apelime nuk u pranuan për shkak të mungesës së legjitimitetit për apelim. Kolegji Zgjedhor gjykoj shtatë apelime kundër vendimeve të KAS-it, duke hedhur poshtë plotësisht dhe pjesërisht dy prej tyre. Shqyrtimi i apelimeve si në KAS, ashtu edhe në Kolegjin Zgjedhor, u bë përmes një procesi të hapur dhe me pjesëmarrje, duke respektuar të drejtat procedurale të palëve.⁹²

Deri më 20 prill, MKVZ-ja e ODIHR-it u informua për 32 raportime veprash penale që lidhen me zgjedhjet të marra nga prokuroritë në të gjithë vendin dhe për 14 procedime penale deri më 20 prill. Shkeljet zgjedhore në lidhje me korrupsionin ndiqen penalisht nga SPAK.⁹³ Deri më 23 prill, SPAK e ka njoftuar MKVZ-në e ODIHR-it për 91 raportime që lidhen me zgjedhjet dhe për 32 procedime penale të iniciuara nga gjykatat, shumica prej të cilave lidheshin me shitblerjen e votës.⁹⁴

Pjesëmarrja e pakicave kombëtare

Kushtetuta parashikon të drejta të plota politike, civile dhe sociale për personat që u përkasin pakicave kombëtare, në përputhje me angazhimet e OSBE-së. Në Shqipëri ndodhen nëntë pakica kombëtare të njohura zyrtarisht.⁹⁵ Regjistrimi i vitit 2011 rendit më pak se 1.5 për qind të popullatës, si pjesë të një pakice kombëtare; megjithatë, kjo shifër konsiderohet e pasaktë.⁹⁶ Disa parti raportuan se kishin anëtarë dhe kandidatë që u përkisnin pakicave kombëtare. Lejohet bërja e fushatës në gjuhët e pakicave kombëtare.⁹⁷

⁸⁹ Më 26 mars, Komisioneri kërkoi zyrtarisht një shqyrtim të përsheptuar në lidhje me regjistrimin e kandidatëve, pasi afati dhjetë-ditor mund të binte ndesh me afatin kohor për prodhimin dhe shpërndarjen e fletëve të votimit. Paragrafi 95 i [Shënimeve Shpjeguese të Kodit të Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias](#) rekomandon një afat kohor prej tre deri në pesë ditë në shkallën e parë për vendimet që duhet të merren para zgjedhjeve, dhe e bën të qartë se është e lejueshme që “t” u jepet më shumë kohë vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese”.

⁹⁰ Portali i KQZ-së u lejoi ankuesve që të mos e zbulojnë identitetin. KQZ-ja informoi se raportet anonime merren në konsideratë nëse faktet e paraqitura kërkojnë ndërmarrjen e një hetimi apo të hapave të caktuar.

⁹¹ Nga këto, tetë kishin të bënin me akreditimin e vëzhguesve të partive, kurse të tjerat me konfigurimin e fletës së votimit, përbërjen e KQV-ve, regjistrimin e listave të partive, ndarjen e minutazhit falas në media, veprimet e Komisionerit në përgjigje të denoncimeve në lidhje me fushatën, si dhe me ndarjen e fondeve të buxhetit të shtetit mes subjekteve.

⁹² Megjithëse seancat e KAS-it dhe të Kolegjit Zgjedhor u mbajtën fizikisht, për shkak të kufizimeve të COVID-19, vetëm palët e përfshira në çështjet e shqyrtuara dhe një numër i kufizuar vëzhguesish u lejuan të ishin të pranishëm. Seancat e KAS-it u transmetuan drejtpërdrejt nga faqja zyrtare e KQZ-së.

⁹³ SPAK e filloi punën në vitin 2019 me hetimin dhe ndjekjen penale të veprave të korrupsionit.

⁹⁴ Nga 91 raportet e paraqitura në SPAK, 55 u paraqitën nga kandidatët, 18 nga Presidenti i Republikës, 10 nga policia gjyqësore, 4 nga prokuroritë e rretheve dhe 4 nga qytetarë.

⁹⁵ [Ligji për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare](#), në fuqi që prej vitit 2017, njeh pakicat kombëtare arumune, boshnjake, bullgare, egjiptiane, greke, maqedonase, malazeze, rome dhe serbe.

⁹⁶ Pakica kombëtare greke përbën 0.87 për qind të popullatës, ajo rome - 0.3 për qind, dhe maqedonase etnike - 0.2 për qind. Është e rëndësishme të theksohet se 14 për qind e të anketuarve zgjedhën të mos i përgjigjen pyetjes për etninë. Shih Raportin e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës, Komitetit Këshillimor për Opinionin për Shqipërinë [ACFC/OP/IV\(2018\)006](#); Sipas INSTAT, një regjistrim i ri për Strehimin dhe Popullsinë, i planifikuar fillimisht për vitin 2020, parashikohet tani të kryhet në tetor të vitit 2022.

⁹⁷ MKVZ-ja e ODIHR-it vëzhgoi fushatën në gjuhën greke.

KQZ-ja, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, përktheu dhe publikoi në faqen e saj zyrtare informacione për procedurat e votimit në gjuhët e të gjitha pakicave kombëtare.⁹⁸ Përveç kësaj, faqja zyrtare e KQZ-së përmban postera që kanë të bëjnë me identifikimin e zgjedhësve dhe me specifikimin e krimeve zgjedhore në gjuhët e pakicave kombëtare. Që të gjithë bashkëbiseduesit e MKVZ-së së ODIHR-it theksuan se shumica e pakicave kombëtare në Shqipëri e flasin dhe e kuptojnë shumë mirë gjuhën shqipe. Bashkëbiseduesit e MKVZ-së së ODIHR-it nga komuniteti rom theksuan se për këto zgjedhje, asnjë nga drejtuesit e komunitetit nuk u trajnua për procedurat e votimit, informacione që normalisht ata më pas do t'i shpërndanin tek anëtarët e komunitetit.⁹⁹ OJQ-të rome raportuan tek MKVZ-ja e ODIHR-it se shumë romë nuk kanë karta identiteti, gjë që ua kufizon mundësinë për të marrë pjesë në zgjedhje.

Në përgjithësi nuk u vu re asnjë lloj diskriminimi i drejtpërdrejtë ndaj pakicave kombëtare në lidhje me procesin zgjedhor. Shumica e bashkëbiseduesve nga pakicat kombëtare raportuan se kishin marrëdhënie të mira me autoritetet dhe u shprehën se komunitetet e tyre nuk përballen me asnjë lloj diskriminimi sa i përket pjesëmarrjes në zgjedhje. Disa anëtarë në komunitetet më të varfra kanë perceptimin se politikanët kujdesen vetëm për votat dhe jo për situatën e tyre, kështu që ata nuk ishin shumë të prirur të angazhoheshin në procesin zgjedhor. MKVZ-ja e ODIHR-it mori raportime të besueshme se koordinatorët e fushatës së partive më të mëdha i ishin afruar një numri të konsiderueshëm zgjedhësish nga komunitetet rome dhe egjiptiane për t'u blerë votat.¹⁰⁰

Vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgim nga vëzhgues vendas dhe ndërkombëtarë në të gjitha nivelet e administrimit të zgjedhjeve. Partitë parlamentare dhe koalicionet mund të caktojnë përfaqësues të përhershëm në KQZ, kurse partitë e tjera kanë të drejtën të caktojnë përfaqësues në KQZ vetëm për periudhën zgjedhore. Të gjitha subjektet kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues në KZAZ-të, KQV-të dhe VNV-të përkatëse.¹⁰¹ E drejta për të caktuar vëzhgues brenda një koalicioni i takon koalicionit dhe jo partive përbërëse të tij. Ndryshe nga vëzhguesit e partive, ligji ende nuk i lejon vëzhguesit e tjerë vendas të marrin protokollët e numërimit dhe të nxjerrjes së rezultateve.

Procesi zgjedhor u ndoq nga disa organizata vëzhguesish vendas, të cilat u fokusuan në aspekte të ndryshme, duke përfshirë shpërndorimin e burimeve shtetërore, administrimin e zgjedhjeve dhe financimin e fushatës. Disa prej tyre targetuan lloje të ndryshme zgjedhësish – kryesisht zgjedhësit e rinj në moshë dhe zgjedhësit që votonin për herë të parë për rritjen e ndërgjegjësimit të tyre. KQZ-ja regjistroi 17 grupe vëzhguesish vendas me 2,012 vëzhgues.

⁹⁸ MKVZ-ja e ODIHR-it u informua se në disa kanale televizive lokale u transmetuan spote për edukimin e zgjedhësve, të prodhuara në gjuhën greke me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar. Spote edukuese u transmetuan edhe në gjuhën rome; megjithatë, bashkëbiseduesit theksuan se kjo nuk përbën një mënyrë efektive të zëvendësimit të aktiviteteve të komunikimit fizik.

⁹⁹ KQZ-ja konfirmoi se për shkak të situatës së pandemisë, nga KQZ-ja nuk u krye asnjë lloj aktiviteti fizik komunikimi me zgjedhësit.

¹⁰⁰ OJQ-të rome raportuan se kjo praktikë është e zakonshme dhe se shumë votues do t'i shisnin votat, të shtyrë nga varfëria.

¹⁰¹ Organizatat e vëzhguesve vendas dhe partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje kanë të drejtë të caktojnë një vëzhgues për KZAZ, KQV dhe në tryezat e numërimit; dy vëzhgues ndërkombëtarë. Koalicionet kufizohen në tre vëzhgues për KZAZ, KQV dhe tryezë numërimi.

Dita e Zgjedhjeve

MNVZ-ja nuk i vëzhgoi procedurat e ditës së zgjedhjeve në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse. Në pjesën më të madhe të qendrave të vizituara të votimit, procesi i votimit që përgjithësisht i qetë.¹⁰² KQZ-ja deklaroi fillimisht se pjesëmarrja në votime ishte 47.9 për qind në ditën e zgjedhjeve.¹⁰³

Në qendrat e vizituara të votimi, procedurat përgjithësisht u respektuan, por zgjedhësit shpesh nuk i hoqën maskat për qëllime identifikimi dhe procedura e shenjimit të gishtit me bojë nuk u ndoq në mënyrë strikte. Masat parandaluese të COVID-19 nuk u zbatuan mirë dhe distancimi social nuk u respektua gjithmonë, sidomos në qendrat me një numër të madh njerëzish që u vëzhguan. Fshehtësia e votës u respektua përgjithësisht në qendrat e vizituara të votimit.

Në qendrat e vizituara të votimit, identifikimi elektronik u krye përgjithësisht sipas procedurave; megjithatë, sipas KQZ-së, 4 për qind e qendrave të votimit u hapën me vonesë kryesisht për shkak të çështjeve që kishin të bënin me vënien në punë të pajisjeve të identifikimit elektronik. Përveç kësaj, KQZ-ja gjithashtu raportoi se në rreth 3 për qind të qendrave të votimit, ose për shkak të mosfunksionimit të pajisjeve të identifikimit elektronik ose për shkak të mungesës së operatorëve teknikë, zgjedhësit u regjistruan duke përdorur listat fizike të zgjedhësve. Në disa prej qendrave të vëzhguara të votimit, komisionerët përdorën paralelisht edhe identifikimin elektronik, edhe listat fizike të zgjedhësve.

Për këto zgjedhje, çdo qendër votimi ishte e pajisur me kamera. Shumica e qendrave të vëzhguara të votimit nuk ishin pa pengesa për personat me aftësi të kufizuara. MNVZ-ja vëzhgoi votimin elektronik në një numër të kufizuar qendrash votimi, ku shumë zgjedhës kërkonin asistencë në procesin e votimit.

Në disa qarqe, MNVZ-ja vuri re grupe djemsh të mbledhur jashtë qendrave të votimit, që dukeshin sikur kontrollonin zonën dhe shihnin se kush votonte. Në qarkun e Shkodrës, vëzhguesit vunë re një person që tërhoqte dikë tjetër për ta futur në qendrën e votimit dhe, në momentin që ky i dyti ishte brenda qendrës së votimit, u udhëzua se për kë të votonte. Po në këtë qark, MNVZ-ja që dëshmitare e një rasti të shpërndarjes së parave në afërsi të një qendre votimi.

Në numrin e kufizuar të numërimeve të vëzhguara, procesi që kryesisht transparent dhe i qetë. MNVZ-ja vuri re se disa ekipe numërimi ishin emëruar dhe trajnuar gjatë natës së zgjedhjeve. Transparenca e procesit dëmtohej ndonjëherë për shkak të vendosjes së vëzhguesve tepër larg tavolinave të numërimit dhe mosekspozimit të fletëve të votimit nga ekipet e numërimit në kamera për aq kohë sa do të mjaftonte për t'u shqyrtuar nga publiku. Në vendet e numërimit të vëzhguara nga MNVZ-ja nuk u respektuan masat parandaluese të COVID-19. Numërimi vazhdon.

*Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.
Një përkthim jozyrtar është i disponueshëm në gjuhën shqipe.*

¹⁰² Sipas Policisë së Shtetit, një oficer policie i pranishëm gjatë mbylljes së një qendre votimi u plagos me thikë në qarkun e Shkodrës. Ajo konfirmoi, gjithashtu, edhe një incident në një qendër votimi në qarkun e Fierit, ku një person kërcënoi se do të digjte kutitë e votimit.

¹⁰³ Një numër i konsiderueshëm zgjedhësish shqiptarë jetojnë jashtë vendit (shih Regjistrimin e Zgjedhësve). Shumica e tyre nuk mundën të votojnë për shkak të mundësisë për të votuar jashtë shtetit dhe kufizimeve të vendosura ndaj udhëtimeve për shkak të COVID-19.

INFORMACIONE PËR MISIONIN & FALËNDERIME

Tiranë, 26 prill 2021 – Kjo Deklaratë e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), Asamblesë Parlamentare të OSBE-së (OSCE PA) dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE). Ky vlerësim bëhet me qëllim që të përcaktojë nëse zgjedhjet ishin në përmbushje të angazhimeve të OSBE-së, të Këshillit të Evropës dhe detyrimeve dhe standardeve të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendas. Secili prej institucioneve të përfshira në këtë Mision Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve ka miratuar Deklaratën e vitit 2005 të Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve.

Azay Guliyev u emërua nga Kryetari i Radhës i OSBE-së si Koordinatori i Posaçëm dhe drejtues i misionit të vëzhguesve afatshkurtër të OSBE-së. Delegacioni i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së u drejtua nga Reinhold Lopatka, kurse delegacioni i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës u drejtua nga Aleksander Pocij. Ambasadorja Urszula Gacek është Shefe e Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, vendosur këtu më 18 mars.

Kjo Deklaratë e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake bëhet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i fazave të tjera të procesit zgjedhor, duke përfshirë numërimin e votave, nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve, si dhe trajtimin e ankesave apo apelimeve të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. ODIHR-i do të nxjerrë një raport të hollësishëm përfundimtar, duke përfshirë rekomandimet për përmirësime të mundshme, rreth tetë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor. OSCE PA do ta paraqesë raportin e saj në takimin e Komisionit të saj të Përhershëm më 5 korrik 2021. PACE do ta paraqesë raportin e saj para Komisionit të saj të Përhershëm më 28 maj përmes një video-konference nga Strasburgu.

MKVZ-ja e ODIHR-it përfshin 13 ekspertë në kryeqytet dhe 24 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në të gjithë vendin. Në ditën e zgjedhjeve, u dërguan 125 vëzhgues nga 32 vende, duke përfshirë 42 vëzhgues të dërguar nga ODIHR, si dhe një delegacion prej 60 anëtarësh nga OSCE PA, dhe një delegacion me 23 anëtarë nga PACE. Mes vëzhguesve pati 35 për qind gra.

MNVZ-ja dëshiron të falënderojë autoritetet për ftesën për vëzhgimin e zgjedhjeve, si dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme për asistencën e dhënë. Ata i shprehin, gjithashtu, vlerësimin institucioneve të tjera shtetërore, partive politike, mediave dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe përfaqësuesve të komunitetit ndërkombëtar për bashkëpunimin.

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni:

- Ambasador Urszula Gacek, Shefe e MKVZ-së së ODIHR-it, në Tiranë (+355 4 433 0363);
- Katya Andrusz, Zëdhënëse e ODIHR-it (+48 609 522 266), ose Kakha Inaishvili, Këshilltar i ODIHR-it për Zgjedhjet, në Varshavë (+48 691 060 501);
- Andreas Baker, OSCE PA (+45 60 10 81 26);
- Bogdan Torcatoriu, PACE (+33 650 39 29 40);

Adresa e MKVZ-së së ODIHR-it:

Kati i 4-rt, MAK Albania Hotel
Sheshi Italia 2, 1001 Tiranë

Tel: +355 4 433 0363; Email: office@odih.al